

ZGJEDHJET PËR KRYETARË TË KOMUNAVE DHE KUVENDE KOMUNALE NË KOSOVË*

22 TETOR 2017

RAPORTI PËRFUNDIMTAR

BASHKIMI EVROPIAN MISIONI PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE

Misionet e Vëzhgimit të Zgjedhjeve të Bashkimit Evropian janë të pavarura nga institucionet e Bashkimit Evropian. Informatat dhe pikëpamjet e paraqitura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian. As institucionet dhe organet e Bashkimit Evropian, e as ndonjë person që vepron në emër të tyre, nuk mund të mbahen përgjegjës për përdorimin e mundshëm të informacionit që përmban ky raport. Raporti është në dispozicion në versionet në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe. Vetëm raporti në gjuhën angleze duhet të merret si version zyrtar.

* Ky emërtim nuk e paragjykon qëndrimin për statusin dhe është në përputhje me RKS KB 1244/1999 dhe mendimin e GJND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

Përmbledhje	3
Rekomandimet prioritare	6
Hyrje.....	7
Konteksti politik.....	8
Korniza ligjore	9
Ambienti i fushatës	13
Financimi i fushatës	16
Mediat	18
Administrimi i zgjedhjeve.....	22
regjistrimi I Votuesve.....	25
Regjistrimi i kandidatëve	27
Zgjidhja e kontesteve zgjedhore	34
Rekomandimet	42
Rezultatet E Monitorimit Të Mediave Nga EUEOM.....	51

PËRMBLEDHJE

Zgjedhjet e 22 tetorit ishin zgjedhjet e dyta për kryetarë të komunave dhe kuvende komunale të mbajtura në të gjitha komunat e Kosovës pas ‘Marrëveshjes së Brukselit’ të 19 prillit 2013 të arritur ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës me lehtësimin e BE-së. Më 19 nëntor u mbajt raundi i dytë i zgjedhjeve për kryetarë të komunave në 19 nga 38 komunat e Kosovës, përfshirë edhe komunat më të mëdha të Prishtinës dhe Prizrenit. Zgjedhjet për kryetarë të komunave dhe kuvende komunale 2017 u mbajtën pak pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të qershorit 2017 dhe vetëm pak javë pas krijimit të një koalicioni të ri qeverisës.

Në përgjithësi, zgjedhjet u mbajtën në një ambient të qetë dhe konkurrues, duke shënuar kështu një përmirësim krahasuar me zgjedhjet lokale të vitit 2013. Megjithatë, dobësitë e kahershme në procesin zgjedhor të Kosovës nuk ishin adresuar sa duhet para këtyre zgjedhjeve, *mes tjerash*, ato që lidhen me regjistrimin e votuesve, me trajnimin dhe profesionalizimin e këshillave të vendvotimeve, me sistemin me të meta të mëdha për Votimin jashtë Kosove (VJK), me stimulimin e kufizuar për ndjekjen penale të aktiviteteve penale që lidhen me zgjedhjet, me mungesën e mekanizmave efektivë për kërkesat për financimin e fushatës dhe me rregullimin e programeve të sponsoruara në TV.

Procesi zgjedhor ka qenë dukshëm më ndryshe në komunat me shumicë shqiptare krahasuar me komunat me shumicë serbe. Në komunat me shumicë shqiptare zgjedhjet ishin vërtetë konkurruese dhe ambienti i fushatës ishte i qetë, duke u mundësuar kandidatëve të shumtë t’i përcjellin lirshëm mesazhet e tyre tek elektorati. Për dallim, ambienti i fushatës në shumë komunitete të serbëve të Kosovës u shëmtua nga frikësimi që veçanërisht kishte në shënjestër subjektet politike të tjera nga Lista Serbe dhe kandidatët e tyre. Kjo përfshiu trysinë mbi kandidatë individualë për tu tërhequr dhe konkurrencën e kufizuar politike, duke ngritur pikëpyetje mbi parimet kyçe të procesit të përgjithshëm demokratik në ato zona. Procesi zgjedhor në komunat me shumicë serbe nuk i ka përmbushur disa standarde evropiane dhe ndërkombëtare për zgjedhje demokratike.

Të dy ditët e zgjedhjeve ishin të qeta dhe të rregullta. Vëzhguesit e vlerësuan pozitivisht votimin dhe numërimin si proces i zhvilluar kryesisht në mënyrë transparente. Megjithatë, akoma duhet të adresohen disa aspekte të rëndësishme të procesit të votimit dhe numërimit në mënyrë që të përmirësohet më tej procesi në ditën e zgjedhjeve. Veçanërisht puna e stafit të zgjedhjeve u përkeqësua në fazën e numërimit, pasi nuk u ndoqën gjithmonë procedurat për numërimin e votave. Të kuptuarit e procedurave të votimit nga votuesit vazhdon të jetë një fushë që ka nevojë të përmirësohet shumë. Votimi i asistuar u kërkua shpesh dhe jo gjithmonë nga votuesit që nuk ishin në gjendje të votonin në mënyrë të pavarur. Fshehtësia e votës ishte ndikuar negativisht nga praktikrat siç është votimi familjar dhe grupor. Përveç kësaj, qasja në objektet e vendvotimeve për persona me aftësi të kufizuara doli të jetë sfiduese.

Në përputhje me marrëveshjen ndërmjet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) dhe Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), OSBE-ja ofroi këshilla dhe asistencë teknike për katër Komisionet Komunale Zgjedhore (KKZ) dhe 86 Këshillat e Vendvotimeve (KVV) në katër komunat veriore.

Korniza ligjore ofron bazë të mjaftueshme për mbajtjen e zgjedhjeve demokratike në përputhje me standardet ndërkombëtare për të cilat Kosova është zotuar në Kushtetutën e saj. Përkundër disa mangësive të rëndësishme, përfshirë mungesat dhe paqartësitë e paraqitura në raportet e Misioneve

të mëhershme të Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (EU EOM), korniza ligjore mbetet në thelb e pandryshuar që nga zgjedhjet lokale të vitit 2013.

Fushata zgjedhore u zhvillua në atmosferë të qetë para të dy raundeve të zgjedhjeve në shumicën e Kosovës. Garuesit u kishin dhënë prioritet fushatave derë-më-derë, takimeve të vogla të përshtatura për grupe specifike të votuesve dhe përdorimit të mediave sociale, duke organizuar tubime kryesisht në fund të fushatës. Partitë politike nuk e kishin përfshirë rritjen e pjesëmarrjes së grave në politikë në prioritetet e tyre gjatë fushatës. Gratë në përgjithësi ishin të nën-përfaqësuar në audiencë në ngjarjet e fushatës dhe kishin marrë mbështetje të kufizuar nga partitë e tyre për të garuar në zgjedhje.

Fushata në zonat me shumicë shqiptare në masë të madhe u zhvillua në përputhje me kërkesat ligjore të përcaktuara për zgjedhje. Megjithatë, vëzhguesit e EU EOM-së kanë përcjellë disa raste të frikësimit të votuesve dhe kandidatëve në disa komunitete joshumicë dhe në disa raste të blerjes së votës dhe keqpërdorimit të resurseve publike.

EU EOM ka marrë raporte për frikësim në shumicën e komuniteteve serbe të Kosovës, që kishin vënë në shënjestër subjektet politike dhe votuesit që nuk ishin të Listës Serbe. Disa kandidatë nga subjekte politike që nuk ishin në Listën Serbe supozohet që janë tërhequr nga gara si rezultat i këtij frikësimi. Partitë kryesore opozitare, përfshirë Partinë Liberale të Pavarur (SLS) dhe Partinë e Serbëve të Kosovës (PKS), nuk caktojnë kandidatë për kryetarë komune në shumicën e komunave të Kosovës me shumicë serbe. Para fillimit të periudhës zyrtare të fushatës ndodhën incidente të dhunshme, përfshirë djegien e automjeteve të dy kandidatëve të njohur të opozitës për kryetarë të komunës. Institucionet që funksionojnë nën 'sistemin e Serbisë' në Kosovë u përfshinë në trysninë mbi kandidatët që nuk ishin të listës Serbe dhe familjet e tyre, në disa raste të raportuara duke çuar në largimin e tyre nga puna. Rastet më të rënda të frikësimit që përfshinin frikësimin e kandidatëve që nuk ishin të Listës Serbe shumë rrallë raportoheshin në sistemin e drejtësisë së Kosovës. Ambienti i fushatës ishte veçanërisht i tensionuar në veri, me incidente të dhunshme të përsëritura ku ishin të përfshirë përkrahësit e PKS-së dhe Listës Serbe në Leposaviq.

Mediat elektronike mbuluan gjerësisht fushatën zgjedhore në një varg formatesh të ndryshme dhe u ofruan votuesve informata për opsionet e ndryshme politike në dispozicion. Mbulimi në lajme i fushatës zgjedhore ishte mjaft i balancuar. Shumica e mediave elektronike në mënyrë pozitive organizuan debate zgjedhore gjithëpërfshirëse ndërmjet kandidatëve për kryetarë të komunës për shumicën e komunave me shumicë shqiptare, ndërsa nuk ia dolën të organizonin debate në komunat me shumicë serbe. Dispozitat e paqarta ligjore u kanë mundësuar garuesve të blejnë gjerësisht mbulueshmëri të sponzoruar, përveç reklamimit të paguar politik të rregulluar në mënyrë të rreptë. Kjo bëri që disa kanale televizive të ofrojnë numër të konsiderueshëm të programeve me pagesë krahasuar me mbulimin redaktorial, në dëm të ofrimit të informatave të duhura votuesve. Komisioni i Pavarur për Media (KPM) nuk i adresoi në mënyrë efektive të gjitha shkeljet e mediave që ndodhën gjatë fushatës zgjedhore.

Administratat e zgjedhjeve në nivelet qendrore dhe komunale i zhvilluan përgatitjet teknike në mënyrë të organizuar mirë dhe transparente. Seancat e KQZ-së ishin të hapura për publik dhe anëtarët e KQZ-së punuan si kolegji duke marrë shpesh vendimet në mënyrë unanime. KQZ është politikisht gjithëpërfshirëse dhe është përpjekur të marrë vendimet me konsensus, dhe si rregull, bëri përpjekje të zhvillojë një proces transparent dhe të mirëfilltë.

Besimi i publikut në saktësinë e regjistrit të votuesve mbetet shumë i ulët pasi që ai përfshin një numër të madh të personave të vdekur. Kishte një rrezik sistemik që të dhënat e regjistruara të rreth gjysmë milioni votuesve që jetojnë jashtë vendit mund të keqpërdoren në ditën e zgjedhjeve. Përveç

kësaj, votuesit jo gjithmonë ishin caktuar në vendvotimin më të afërt me vendbanimin e tyre. Bazuar në të dhënat e përpiluara nga regjistrave civil KQZ ka regjistruar 1,890,952 votues, duke paraqitur një rritje prej 18,011 votuesve nga zgjedhjet e qershorit 2017.

Procesi i caktimit dhe certifikimit të kandidatëve për zgjedhjet lokale ishte gjithëpërfshirës. Gjatë periudhës së certifikimit u certifikuan që të 91 subjektet politike që kishin aplikuar. Ishin 6,887 kandidatë të certifikuar që garuan për kuvendet komunale, prej të cilëve 2,400 ishin gra. Numri i përgjithshëm i kandidatëve për kryetarë të komunave ishte 204, vetëm tetë prej të cilëve ishin gra. Për herë të parë KQZ ka kërkuar dokumentacionin penal të të gjithë kandidatëve që aplikuan për certifikim, siç kërkohet me ligj. Tetëdhjetë e shtatë kandidatë u de-certifikuan nga KQZ për shkak se kishin qenë të dënuar për vepër penale në tri vitet e fundit. Kundër këtij vendimi të KQZ-së u parashtrua ankesë në Gjykatën Supreme e cila argumentoi se neni 29.1 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) ishte jokushtetues, dhe urdhëroi KQZ-në të certifikojë tre kandidatët që kishin parashtruar ankesë. Pastaj KQZ në mënyrë pragmatike vendosi të aplikojë vendimin e Gjykatës Supreme për të 87 kandidatët që fillimisht ishin de-certifikuar. Mbetet në mandatin e Gjykatës Kushtetuese që të shpall një ligj si jokushtetues.

Kryesisht për shkak të punës joprofesionale të KVV-ve, fletëvotimet nga pothuaj 30 për qind e vendvotimeve (VV) në tërë Kosovën u desh të rinumërohen. Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) rinumëroi 717 kuti të votimit për kuvende komunale, të cilat nuk e kaluan kontrollin e formularëve të rezultateve. Analiza e EU EOM-së u bazua në një mostër të madhe të formularëve të rezultateve. Çka është me rëndësi, dhjetë për qind e formularëve të analizuar treguan mospërputhje prej më shumë se pesë votash për një subjekt politik, ku dallimi më i madh ishte 123 vota.

Procesi i rinumërimit në QNR u zhvillua në prani të vëzhguesve të subjekteve politike, dhe u vlerësua nga vëzhguesit e EU EOM si kryesisht transparent. Në përgjithësi, QNR luan një rol të rëndësishëm në ofrimin e nivelit aq të nevojshëm plotësues të kontrollit të procesit zgjedhor dhe mbetet e domosdoshme për të siguruar të dhëna të sakta nga vendvotimet.

Përqindja e fletëvotimeve të pavlefshme dhe të zbrazëta në zgjedhjet për kuvendet komunale të mbajtura me 22 tetor mbetet shumë më e lartë se përqindja në zgjedhjet për kryetarë të komunave. Numri i përgjithshëm i fletëvotimeve të pavlefshme për zgjedhjet komunale ishte 8.7 për qind ku pjesa e fletëvotimeve të pavlefshme në zgjedhjet për kryetarë të komunave ishte 2.6 për qind, përfshirë fletëvotimet e zbrazëta. Ky numër i fletëvotimeve të pavlefshme në zgjedhjet komunale është jashtëzakonisht i lartë në kontekstin evropian, megjithatë pati një rënie krahasuar me zgjedhjet për kuvende komunale të vitit 2013 ku numri i fletëvotimeve të pavlefshme ishte 10.1 për qind.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) e ka trajtuar një numër të madh të ankesave dhe apeleve brenda afatit të shkurtër kohor të përcaktuar me ligj, por praktika e panelit për të refuzuar ankesat të cilat ishin paraqitur në mënyrë të rregullt pas mbylljes së VV-ve si të parakohshme ka çuar në akumulimin e ankesave pas publikimit të rezultateve dhe në zgjatjen e procesit për certifikimin e rezultateve. PZAP e konsideroi një ankesë nga një kandidat për kryetar të komunës lidhur me blerjen e votave si të bazuar dhe vendosi të anuloi rezultatet e zgjedhjeve për kryetar komune në Partesh, duke e urdhëruar KQZ-në të përsëris këto zgjedhje.

Atmosfera pas ditës së dytë të zgjedhjeve u karakterizua me tension që ndikoi kryesisht në komunat ku rezultatet ishin shumë të ngushta. Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK) nuk i pranuan rezultatet paraprake në Prishtinë dhe Prizren dhe vendosën të parashtronë ankesa në PZAP duke kërkuar rinumërimin e plotë në të dy komunat e mëdha.

PZAP urdhëroi që të bëhet rinumërimi në të gjitha vendvotimet në Prishtinë dhe Prizren. Këto vendime të PZAP-së bazoheshin në dëshmitë e pakta të ofruara, pa ndërmarrë asnjë hetim të mëtejshëm dhe pjesërisht të arsyetuara në mënyrë të paqëndrueshme. Këto nuk u pranuan nga kandidatët për kryetarë të komunave nga Vetëvendosja (VV), të cilët parashtruan ankesë kundër vendimeve të PZAP-së në Gjykatën Supreme. Gjykata Supreme vendosi kundër rinumërimit të plotë që ishte urdhëruar nga PZAP për të gjitha vendvotimet në Prishtinë dhe Prizren, duke hedhur poshtë ankesat përkatëse të LDK-së dhe PDK-së. Në përgjithësi, këto vendime të PZAP-së kanë ndikuar negativisht në besimin e publikut në procesin e parashtrësive dhe ankesave.

Më 29 nëntor, pas publikimit të rezultateve të raundit të dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave, në PZAP u parashtruan shtatë ankesa lidhur me rezultateve përfundimtare të publikuara, përfshirë edhe për ato në Prishtinë dhe Prizren. PZAP i refuzoi që të shtatë ankesat. Më pas ishin parashtruar katër ankesa kundër këtyre vendimeve të PZAP-së në Gjykatën Supreme, e cila i konfirmoi në tërësi vendimet e PZAP-së me 8 dhjetor.

REKOMANDIMET PRIORITARE

- **Efikasiteti dhe performanca e Këshillave të Vendvotimeve (KVV)**

Të krijohet pozita e Sekretarit të KVV-së për t'i ofruar mbështetjen e nevojshme këshilluese dhe administrative kryesuesit të KVV-së. Sekretari mund të rekrutohet dhe trajnohet prej KQZ/KKZ nga pjesëtarët e administratës publike. Të intensifikohet trajnimi i stafit zgjedhor për të adresuar mangësitë e vazhdueshme siç janë mosrespektimi i procedurave të numërimit të votave dhe plotësimi jo i saktë i formularëve të rezultateve.

- **Kapaciteti i votuesve për të hedhur votë të vlefshme**

Të përmirësohet dizajni i fletëvotimeve për zgjedhjet për kuvende komunale që votuesit t'i kuptojnë më mirë. Të përmirësohet informimi i votuesve për atë se si të shënjohe në mënyrë të saktë një fletëvotim.

- **Listat e votuesve**

Të përmirësohet saktësia e listave të votuesve dhe caktimi i votuesve në vendvotime. Të bëhen përpjekje substanciale për heqjen e personave të vdekur nga regjistrat civilë, dhe të krijohet një sistem i unifikuar i adresave në Kosovë.

- **Financimi i fushatës**

Të zbatohen si duhet kushtet për financimin e fushatës duke bërë në mënyrë efektive auditimin e financimit të fushatave të garuesve në zgjedhje. Mund të mendohet edhe të bëhet një shqyrtim gjithëpërfshirës i kornizës ligjore që rregullon financimin e fushatës dhe të partive politike.

- **Koha e transmetimit me pagesë në media**

Të kufizohet numri i programeve politike të sponsorizuara që transmetohen nga mediat elektronike dhe të sigurohen kushte të barabarta për garuesit në kohën e transmetimit me pagesë. Duhet të mendohet edhe për rregullimin e programeve të sponsorizuara nga garuesit politikë ngjashëm me spotet reklamuese politike me pagesë.

- **Votimi jashtë Kosovës**

Masa të tjera shtesë mbrojtëse duhet të merren parasysh në mënyrë që të mbrohet integriteti i procesit të votimit jashtë Kosovës.

- **Procesi i ankesave dhe parashtrësive**

Të ofrohet qartësi ligjore për afatet e ndryshme të ankesave, dhe mundësi ligjore për parashtrimin e ankesës ose parashtrësës kundër rezultateve përfundimtare. T'u sigurohet ankuesve kohë e mjaftueshme për përgatitjen e ankesës lidhur me votimin dhe numërimin, për paraqitjen e dëshmimeve dhe për PZAP-në që të ekzaminojë dëshmitë para marrjes së vendimit.

HYRJE

Me ftesën e Presidentit të Kosovës të bërë me 25 prill 2017, BE dërgoi një Mision për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (EOM) me 12 shtator për të vëzhguar zgjedhjet komunale dhe për kryetarë të komunave të caktuara për 22 tetor 2017 dhe raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave të datës 19 nëntor 2017. EU EOM u udhëhoq nga Z. Alojz Peterle, deputet i Parlamentit Evropian dhe ish Kryeministër i Republikës së Sllovenisë. Misioni përfshinte një Ekip Kryesor prej tetë analistëve, 20 vëzhgues afatgjatë (LTO), të cilët ishin të pranishëm prej 19 shtatorit, dhe 42 vëzhgues afatshkurtër (STO) që ishin të pranishëm prej 18 deri me 24 shtator dhe 30 STO prej 16 deri me 21 nëntor. Përveç kësaj, Misionit iu bashkuan edhe 38/15 vëzhgues afatshkurtër të rekrutuar lokalë (LSTO).

Në ditën e zgjedhjeve, EU EOM shpërndau gjithsej 109 vëzhgues nga 26 vende anëtare të BE-së, Norvegjia dhe Zvicra gjatë raundit të parë dhe 72 vëzhgues nga 25 vende anëtare, Norvegjia dhe Zvicra në tërë Kosovën gjatë raundit të dytë të zgjedhjeve për të vlerësuar tërë procesin zgjedhor duke e krahasuar me standardet ndërkombëtare dhe evropiane për zgjedhje demokratike si dhe me ligjet e Kosovës. Misionit iu bashkuan edhe 38 vëzhgues me 22 tetor dhe 15 vëzhgues me 19 nëntor nga përfaqësitë diplomatike të shteteve anëtare të BE-së dhe Norvegjisë, si dhe nga Zyra e BE-së/EUSR për të vëzhguar procesin në ditën e zgjedhjeve. Në ditën e zgjedhjeve me 22 tetor, vëzhguesit vizituan 466 vendvotime dhe me 19 nëntor vizituan 292 vendvotime për të vëzhguar votimin dhe numërimin. LTO-të mbetën në terren për të përcjellë procedurat pas ditës së zgjedhjeve dhe për të vëzhguar aktivitetet në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve në Prishtinë. Shumica e Ekipit Kryesor u largua me 12 dhjetor, pesë ditë më vonë se sa që ishte paraparë fillimisht, në mënyrë që t'i përcillnin procedurat e ankesave dhe parashtrësive në Prishtinë dhe Prizren. Dy anëtarët e tjerë të ekipit u larguan me 20 dhjetor, pas përsëritjes së raundit të dytë të zgjedhjeve për kryetar të komunës në Istog.

EU EOM e vlerësoi tërë procesin zgjedhor duke e krahasuar me standardet ndërkombëtare dhe evropiane të zgjedhjeve demokratike si dhe me ligjet e Kosovës. EU EOM është i pavarur në gjetjet dhe konkluzionet e tij dhe vepron në përputhje me Deklaratën e Parimeve për Vëzhgimin Ndërkombëtar të Zgjedhjeve.¹

EU EOM dëshiron t'i falënderojë autoritetet kosovare, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, Prokurorinë Publike dhe institucionet e tjera, Policinë, partitë politike, mediat dhe shoqërinë civile për bashkëpunimin dhe ndihmën e tyre gjatë gjithë pranisë së

¹ Edhe pse raporti është përkthyer në gjuhën shqipe dhe serbe, versioni në gjuhën angleze mbetet i vetmi version zyrtar.

Misionit. EU EOM po ashtu falënderon Zyrën e BE/EUSR në Kosovë, EULEX-in, KFOR-in, OSBE-në dhe përfaqësitë diplomatike të shteteve anëtare, Norvegjinë dhe Zvicrën.

KONTEKSTI POLITIK

Zgjedhjet për kryetarë të komunave dhe për kuvende komunale të 22 tetorit ishin zgjedhjet e dyta lokale të mbajtura në të gjitha komunat e Kosovës që nga Marrëveshja e 19 prillit 2013 ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit dhe u organizuan pak kohë pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 11 qershorit 2017. Votuesit kosovarë duhej të votonin të zgjedhnin kryetarin dhe anëtarët e kuvendeve komunale përmes një sistemi përfaqësues proporcional me votim preferencial në 38 komunat e tërë Kosovës.

Dy muaj pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve parlamentare, Aleanca Kosova e Re (AKR) e braktisi koalicionin parazgjedhor me Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Alternativën për t'iu bashkuar Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Nismës për Kosovën (NISMA), Listës Serbe dhe disa partive të tjera politike që përfaqësonin komunitetet jo-shumicë për të formuar ekzekutivin, edhe pse me një shumicë të ngushtë. Vetëvendosje (VV), me grupin më të madh të deputetëve në Kuvend, ishte në opozitë, siç ishte edhe ish partia e koalicionit qeverisës LDK.

Akterët kryesorë politikë

Prej 91 subjekteve politike të certifikuara për të garuar në këto zgjedhje, 54 ishin shqiptare, 24 serbe, tri turke, tri gorane, tri boshnjake, dy ashkali, një egjiptiane, një rome dhe 25 kandidatë të pavarur. Të gjitha partitë e përfaqësuara në Kuvend garuan në mënyrë të pavarur në këto zgjedhje komunale për dallim nga zgjedhjet parlamentare kur ishin formuar dy koalicione të mëdha parazgjedhore. Edhe pse të gjitha partitë kryesore politike paraqitën kandidatë në shumicën e komunave të Kosovës, shumica e tyre i fokusuan resurset në disa komuna të përzgjedhura. PDK i paraqiti 30 kandidatë për kryetarë të komunave, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) 25, Aleanca Kosova e Re (AKR) 16 dhe NISMA 23. Vetëvendosja e opozitës i paraqiti 26 kandidatë për kryetarë të komunave dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) 28. Gjithsej 12 deputetë të Kuvendit garuan për pozitën e kryetarit të komunës: gjashtë nga VV, dy nga PDK, një nga NISMA, një nga Alternativa, një nga LDK dhe një nga Partia e Re Demokratike (NDS)². Prej gjithsej 204 kandidatëve për kryetarë të komunave vetëm tetë ishin gra, tri nga të cilat nga PDK.

Nga 38 garat për kryetarë të komunave, 19 kandidatë fituan që në raundin e parë. LDK fitoi katër poste të kryetarit të komunës, AAK fitoi dy, PDK dhe Partia Demokratike Turke e Kosovës (KDTP) fituan nga një post. Lista Serbe fitoi nëntë nga dhjetë komunat me shumicë serbe në raundin e parë. Kandidatët e pavarur Bekim Jashari dhe Refki Suma i fituan postet e kryetarit të komunës në Skenderaj dhe Han të Elezit, respektivisht. Mbi dy të tretat e votuesve në Kosovë e kanë zgjedhur kryetarin e tyre gjatë raundit të dytë, përfshirë komunat më të mëdha të Prishtinës dhe Prizrenit.³ Në raundin e dytë, AAK fitoi pesë poste të kryetarit, PDK katër, LDK tri, VV tri ndërsa Lista Serbe, Alternativa, NISMA, AKR, Iniciativa Qytetare (IQ) Narodna Sloga - Partesh dhe Iniciativa Qytetare

² Neni 9.3 i Ligjit për Zgjedhjet Lokale thekson se kandidati i zgjedhur kryetar i komunës nuk do të ketë të drejtë të mbajë pozitën në Kuvendin e Kosovës apo Kuvendin e Komunës.

³ Kryetari ekzistues i komunës në Pejë fitoi që në raundin e parë.

Kllokot-Vrbovc i fituan nga një post.⁴ Nga tetë gratë që garuan për pozitë të kryetares së komunës në raundin e parë, vetëm dy kandidatë kaluan në raundin e dytë, një në Gjakovë dhe një në Mitrovicë (Jug).

Që nga viti 2013, Lista Serbe e ka dominuar jetën politike në komunitetet me shumicë serbe të Kosovës. Kjo parti i paraqiti kandidatët e vet në të dhjetë komunat ku serbët përbëjnë shumicën dhe u përballën me konkurrencë të kufizuar, përveç në Mitrovicë (Veri), Zveçan, Kllokot dhe Partesh. Iniciativa Qytetare “Serbia, Demokracia, Drejtësia - Oliver Ivanović” (IQ - SDP Oliver Ivanović) gëzonte mbështetje publike kryesisht në Mitrovicë (Veri) dhe Zveçan. Oliver Ivanović e sfidoi kryetarin aktual të Mitrovicës (Veriore) të Listës Serbe Goran Rakić, i cili është udhëheqës aktual i Listës Serbe. IQ “Për Zveçanin Tonë” ka paraqitur kandidatin për kryetar të komunës Dragiša Milović dhe një listë të kandidatëve për kuvendin komunal në Zveçan. Tri iniciativa qytetare të serbëve të Kosovës që garonin për herë të parë në Kllokot i bashkuan forcat për të garuar me Listën Serbe: Aktivna Građanska Inicijativa (AGI), Narodno Jedinstvo (NJ) dhe IQ Kllokot-Vrbovac (GIKV) dhe e kanë mbështetur udhëheqësin e GIKV-së Božidar Dejanović si kandidat për kryetar të komunës. Po ashtu duke garuar për herë të parë në zgjedhjet komunale, Iniciativa Qytetare Narodna Sloga e paraqiti Nenad Cvetković si kandidat për kryetar të Parteshit. Ish udhëheqësi i Listës Serbe, Aleksandar Jablanović, ka formuar Partinë e Serbëve të Kosovës (PKS) dhe kjo parti garoi për kryetar të komunës vetëm në Leposaviq. Partia Liberale e Pavarur (SLS), e udhëhequr nga Slobodan Petrović, ka zhvilluar fushatë vetëm për kuvendet komunale në Graçanicë dhe Shtërpcë me gjithsej 68 kandidatë për kuvendet lokale, por nuk ka garuar për pozitë të kryetarit në ato komuna. Partia Progressive Demokratike (PDS) e udhëhequr nga Nenad Rasić, ka garuar në Graçanicë dhe në disa fshatra në rajonin e Gjilanit me vetëm një kandidat për postin e kryetarit të komunës në Ranillug.

Për komunitetet e tjera joshumicë, pretenduesit kryesorë ishin VAKAT, një koalicion i katër partive politike boshnjake, Partia e Re Demokratike (NDS), që po ashtu përfaqësonte komunitetin boshnjak, KDTP, Partia e Re Rome e Kosovës (KNRP), Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), Partia Unike Gorane (JGP) dhe Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës (PDAK).

KORNIZA LIGJORE

Korniza ligjore për qeverisjen e zgjedhjeve në Kosovë ofron bazë të mjaftueshme për mbajtje të zgjedhjeve demokratike në përputhje me standardet ndërkombëtare. Pjesët relevante të legjislacionit në Kosovë janë Kushtetuta e Kosovës dhe Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme (PZP), Ligji për Zgjedhjet Lokale (LZL) dhe Ligji për Vetëqeverisjen Lokale (LVQL). Legjislacioni përkatës sekondar përfshin rregulloren e punës së KQZ-së, rregulloren e punës së PZAP-së dhe 19 rregullat e nxjerra më 2013, 2015 dhe 2016 nga KQZ, të cilat zgjerojnë parimet e përfshira në LZP. Ligjet e tjera relevante për procesin zgjedhor janë Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Kosovë (LMPDKP), Ligji për Gjuhët dhe Ligji për Financimin e Partive Politike.

Kosova nuk është palë nënshkruese e asnjë traktati për të drejtat e njeriut. Megjithatë, neni 22 i Kushtetutës thekson se disa marrëveshje dhe instrumente të rëndësishme për zgjedhjet zbatohen drejtpërdrejt në Kosovë, dhe në rast të konfliktit, kanë përparësi ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve

⁴ Zgjedhjet u përsëritën në Partesh për raundin e parë dhe në Istog për raundin e dytë.

të tjera të institucioneve publike⁵. Po ashtu, Kosova nuk është palë nënshkruese e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), por neni 53 i Kushtetutës i detyron autoritetet që të interpretojnë të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me ligj dhe kushtetutë në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Megjithatë, nuk ka mjet juridik në dispozicion në GJEDNJ lidhur me vendimet, aktet dhe lëshimet e ekzekutivit dhe institucioneve kosovare. Me 11 qershor 2014, Kosova u bë anëtare e Komisionit të Venedikut. Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore i Komisionit të Venedikut nga tetori 2002 tani ka rëndësi më të madhe si referencë për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike në Kosovë.

Prej vitit 2011, në disa raste është lansuar procesi i reformës zgjedhore, por ka ngecur siç raportohet për shkak të mungesës së vullnetit politik dhe konsensusit ndërmjet partive. Prej vitit 2013, në Kosovë janë vendosur tri misione EU EOM që kanë dhënë rekomandime se si të reformohet procesi zgjedhor për ta harmonizuar plotësisht me standardet ndërkombëtare dhe evropiane. Këto rekomandime përfshijnë, mes tjerash, përmirësimin e saktësisë së listave të votuesve, ofrimin e konsistencës ligjore në rregullat e fushatës zgjedhore, përmirësimin e transparencës së financimit të fushatës, zbatimin në mënyrë efektive të kërkesave për financimin e fushatës, rregullimin e programeve televizive të sponsorizuara nga partitë politike dhe zgjatjen e afateve për parashtrimin dhe marrjen e vendimit për një ankesë për zgjedhjet. Asnjë prej këtyre rekomandimeve që kërkojnë ndryshime në kornizën ligjore nuk është zbatuar.

Mangësitë në LZP plotësohen me dispozitat e 19 rregullave zgjedhore të KQZ-së dhe me Rregulloren e Punës së PZAP-së. Të gjitha këto duhet të rregullohen me ligj pasi që kanë të bëjnë me aspektet kryesore të procesit zgjedhor. Këto përfshijnë procedurat në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), të cilat adresohen vetëm në Rregullën e KQZ-së nr.6 dhe nr.9. Procedura dhe kriteret për të vendosur mbi anulimin e rezultateve të zgjedhjeve dhe urdhërimin e rivotimit janë të paqarta në LZP, dhe janë rregulluar në mënyrë të paqartë në Rregullën e KQZ-së nr.9 dhe nr.6. Në fund, LZP në kombinim me Ligjin për ndryshimin e LZP-së shkakton konfuzion gjatë leximit sa i përket afateve përkatëse për parashtrimin e ankesave dhe praktikisht nuk jep udhëzime lidhur me përmbajtjen minimale të nevojshme të ankesave të tilla. Këto rregulla gjenden në Rregulloren e Punës të PZAP-it, të cilat sigurojnë detajet e nevojshme.

Sistemi zgjedho

Zgjedhjet lokale në Kosovë mbahen çdo katër vjet për të zgjedhur kryetarët e komunave dhe anëtarët e kuvendeve komunale. Kryetarët zgjidhen drejtpërdrejt me sistem të shumicës me dy raunde. Një kandidat/e zgjidhet kryetar/e nëse ai ose ajo merr më shumë se 50 për qind plus 1 të votave të përgjithshme të vlefshme të hedhura në një komunë. Në komunat ku asnjë kandidat nuk e merr shumicën e nevojshme absolute të votave, katër javë pas raundit të parë do të mbahet një raund i dytë i zgjedhjeve ndërmjet dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave. Kandidati që fiton shumicën e votave në balotazh zgjedhet kryetar i komunës.

Anëtarët e kuvendit komunal zgjidhen sipas sistemit proporcional. Secila nga 38 komunat paraqet një zonë të vetme zgjedhore dhe numri i ulëseve sillet prej 15 deri në 51, sipas proporcionit të popullsisë

⁵ Instrumentet në vijim përmbajnë dispozita që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor: Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj; Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj; Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor; Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;

së komunës. Subjektet politike shënohen në një fletëvotim të hapur, dhe votuesit e shënjojnë një subjekt të preferuar politik dhe ia japin një votë preferenciale një kandidati nga lista e po të njëjtit subjekt politik. Votat preferenciale që marrin kandidatët e secilit subjekt politik numërohen ndarazi përveç ato të bartësit të listës i cili automatikisht i merr të gjitha votat e hedhura për subjektin politik.

Kuota gjinore kërkon që subjektet politike të përfshijnë në listë së paku 30 për qind të gjinisë më pak të përfaqësuar. Nga ulëset që i caktohen një subjekti politik, gjinisë që ka fituar më pak ulëse do t'i ndahen të paktën 30 për qind të numrit të përgjithshëm të ulëseve që ka marrë subjekti politik.

Të drejtat zgjedhore

Korniza ligjore jep një përkufizim gjithëpërfshirës të kualifikimit të votuesve. E drejta universale e votës është e garantuar me nenin 45 të Kushtetutës, ku thuhet “çdo shtetas (...) që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.”

LZP shkon përtej kësaj, megjithatë, edhe kur lexohet së bashku me legjislacionin tjetër relevant, siç është Ligji për Regjistrat Civilë dhe Ligji për Shtetësinë, paqartësitë mbeten. Qëllimi i përgjithshëm i këtij korpusi ligjor duket se është për ta bërë kualifikimin për të votuar në përgjithësi gjithëpërfshirës, në mënyrë që jo vetëm shtetasit, por çdo person nga mosha 18 vjeçare që i plotëson kushtet të jetë shtetas i Kosovës, edhe nëse ai/ajo në fakt nuk është i tillë, i jepet e drejta për të votuar. Kjo vlen për të gjithë ata votues potencial të cilët, për shkak të ngjarjeve historike dhe lëvizjeve të popullsisë në dekadat e fundit, nuk janë shtetas të Kosovës. Sipas nenit 5 të LZP, personi ka të drejtë për të votuar nëse ai/ajo është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil; ose nëse ai/ajo ishte banor në Kosovë më 1 janar 1998; ose nëse ai/ajo ka fituar statusin e refugjatit me ose pas 1 janarit 1995, dhe ka të drejtë për t'u regjistruar në Regjistrin Qendror Civil si banor rezident i Kosovës.

Kufizimet e të drejtës për të votuar në LZP i mbulojnë rastet kur një person është shpallur i paafte mendërisht me vendim gjyqësor të formës së prerë, kur është duke vuajtur dënimin e shqiptuar nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ), kur është i akuzuar nga TPNJ dhe kur nuk i është bindur urdhrorit për t'u paraqitur para Tribunalit.

Ky koncept i gjerë i të drejtës për të votuar gjithnjë e më shumë po kufizohet nga çështja se cilat dokumente pranohen për identifikimin e votuesve në ditën e zgjedhjeve. LZP dhe rregulloret e KQZ-së i përshkruajnë si dokumente të pranueshme një pasaportë të vlefshme, një letërnjoftim të vlefshëm, një kartelë të vlefshme të PZHBV-së ose një kartelë të vlefshme të refugjatit pa specifikuar origjinën e dokumenteve; ose lejen e vlefshme e vozitjes të Kosovës. Fakti se origjina e Kosovës specifikohet vetëm në lidhje me lejen e vozitjes, mund të shpie në përfundim se dokumentet e tjera të vlefshme mund të kenë origjinë tjetër. Doracaku për Procedurat e Votimit dhe Numërimit ia shtoi kësaj liste dokumentet e identifikimit të lëshuara nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë UNMIK, por në shtojcë i ka paraqitur vetëm dokumentet e identifikimit të Kosovës dhe një dokument identifikimi i UNMIK-ut, duke ngritur pikëpyetje rreth përdorimit të dokumenteve të identifikimit nga vendet e tjera për identifikim.

Për votuesit me kusht të cilët janë të shënuar në LPV të një Qendre të Votimit (QV), përzgjedhja e një dokumenti të pranueshëm të identifikimit tashmë është e kufizuar në mënyrë të qartë me

juridiksionin e fundit për dokumentet e identifikimit të lëshuara nga Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës⁶.

Bashkëbiseduesit i kanë thënë EOM-së se këto do të jenë zgjedhjet e fundit në të cilat për identifikim do të pranohen dokumentet e identifikimit që nuk janë lëshuar në Kosovë. Kjo - dhe interpretimi i ri për dokumentet e identifikimit që nevojiten për votim me kusht - ngrit çështjen e qasjes në dokumentet e identifikimit të Kosovës. EOM ka marr raporte, veçanërisht por jo vetëm nga katër komunat veriore, për vështirësitë që kanë pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë, veçanërisht serbët, dhe komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane (RAE) për të vërtetuar statusin e shtetësisë dhe për të marrë dokumente identifikimi të Kosovës. Kjo është e vërtetë për të kthyerit dhe për njerëzit që kurrë nuk kanë pasur një dokument identifikimi të (Kosovës ose) UNMIK-ut, e cila nuk ishte e domosdoshme deri më tani për shumë serbë të Kosovës që jetojnë në komunat veriore, ose për pjesëtarët e komunitetit RAE të cilëve u dukej më e lehtë që të regjistrohen në sistemin serb. Është e mundur që problemet aktuale kanë të bëjnë me mungesën e trajnimit të institucioneve përkatëse pasi që Udhëzimi i ri Administrativ ka hyrë në fuqi me 22 korrik 2017, por gjendja duhet të monitorohet me qëllim që të sigurohet qasja në dokumentacionin e nevojshëm për tu regjistruar në LV dhe për të votuar.

Përshtatshmëria/Zotësia e kandidatit

Cilido person emri i të cilit paraqitet në Listën e Votuesve i plotëson kushtet (ka të drejtë) të regjistrohet si kandidat, por LZP e kufizon këtë të drejtë duke iu referuar një numri mjaft të madh të kategorive të personave, p.sh. pjesëtarët e shërbimit të armatosur, gjyqtarët dhe prokurorët, anëtarët e çfarëdo trupi të menaxhimit të zgjedhjeve dhe diplomatët.

Për kandidatët e përfshirë aktualisht në procedura penale, ligji e respekton prezumimin e pafajësisë derisa personi të shpallet fajtor nga gjykata. Një person i shpallur fajtor për vepër penale me një vendim të gjykatës të formës së prerë në tri (3) vitet e fundit; ose që nuk ka paguar gjobën e shqiptuar nga PZAP apo KQZ; ose që ka dështuar t'i përmbahet ndonjë urdhri të PZAP-së, nuk ka të drejtë të garojë si kandidat sipas ligjit. Për personat me dënime penale, Gjykata Supreme e ka gjetur këtë kufizim si jokushtetues gjatë procesit të regjistrimit të kandidatëve për këto zgjedhje. Asnjë person që tashmë është anëtar i një organi tjetër të zgjedhur legjislativ (siç është Kuvendi i Kosovës) nuk mund të marrë ulëse në kuvendin komunal. Duhet hequr dorë nga njëri prej mandateve.

Të drejtat dhe liritë e tjera të rëndësishme për zgjedhjet

Kushtetuta e parasheh parimin e barazisë para ligjit për të gjithë individët dhe respektimin e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të pranuar ndërkombëtarisht si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe

⁶Me 2 korrik 2017, PZAP refuzoi si të pabazuar një ankesë nga Lista Serbe të parashtuar kundër KQZ-së për mospërfshirjen e 1,200 votave me kusht në rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve parlamentare. PZAP vlerësoi se votimi me kusht ishte ndryshe nga votimi i rregullt në atë se votuesve u lejohej të hidhnin votën e tyre edhe nëse emri i tyre nuk gjendej në LPV të QV-së, nëse kanë dokumente identifikimi të lëshuara nga Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës.

Ky vendim më pastaj u mbështet nga Gjykata Supreme. As PZAP e as Gjykata Supreme nuk dhanë asnjë sqarim se pse dispozitat e LZP-së kërkojnë që dokumenti i identifikimit të jetë i lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës. Megjithatë, ky është aktualisht interpretimi zyrtar i ligjit, kështu që rreth 130,000 votues që janë regjistruar në LV me dokument identifikimi të UNMIK-ut nuk do jenë në gjendje më të votojnë me kusht, nëse nuk posedojnë edhe dokument identifikimi të Kosovës, edhe pse ata u lejuan të votojnë në mënyrë të rregullt gjatë këtyre zgjedhjeve. Dokumentet e identifikimit nga vendet e tjera ende janë të vlefshme për qëllime të identifikimi në votimin jashtë Kosovës.

pjesëmarrjen për dhe nga të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre. Çdokush duhet të gëzojë të drejtën për mbrojtje të barabartë ligjore pa diskriminim në çfarëdo baze, dhe të drejtat dhe liritë themelore mund të kufizohen vetëm me ligj.

Dispozitat ligjore gjithashtu parashohin të drejtat dhe liritë që janë thelbësore për një mjedis të favorshëm. Kushtetuta përmban garanci për: lirinë e shprehjes, përfshirë të drejtën për të shpërndarë dhe për të marrë informacione dhe për opinione pa u penguar nga askush; lirinë e tubimit paqësor, lirinë e asociimit – përfshirë të drejtën për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë për leje, dhe për të themeluar sindikata; lirinë e lëvizjes - të gjithë qytetarët kanë të drejtë të lëvizin lirshëm nëpër tërë territorin dhe të zgjedhin vendbanimin e tyre; dhe lirinë dhe pluralizmin e mediave dhe ndalimin e censurës.

AMBIENTI I FUSHATËS

Fushat zgjedhore u zhvillua në atmosferë të qetë para të dy raundeve të zgjedhjeve në pjesën më të madhe të Kosovës, me përjashtim të disa komunave me shumicë serbe. Garuesit u kishin dhënë prioritet fushatave derë-më-derë, takimeve të vogla të përshtatura për grupe specifike të votuesve dhe përdorimit të mediave sociale, ndërsa tubimet kryesisht i organizuan në fund të fushatës. Garuesit kryesisht patën mundësi të përcjellin mesazhet e tyre tek votuesit lirshëm dhe përgjithësisht u përmbajtën nga përdorimi i gjuhës nxitëse. Shumica e subjekteve politike zhvilluan fushatën me mesazhe të përgjithshme për shëndetësinë, arsimin, papunësinë dhe infrastrukturën lokale, pa dallime të mëdha ndërmjet garuesve përkatës dhe me përmbajtje të kufizuar politike.

Korniza ligjore siguron mundësi të barabarta për të gjithë garuesit gjatë fushatës zgjedhore. Kodi i Sjelljes për subjektet politike, mbështetësit dhe kandidatët e tyre e ndalon shfrytëzimin e resurseve publike për të bërë fushatë, si dhe frikësimin e votuesve. Rregullorja e zgjedhjeve e KQZ-së nr. 13/2013 për fushatën zgjedhore dhe njoftimin për ngjarjet politike i përcakton rregullat për vendosjen e materialeve zgjedhore dhe për mbajtjen e ngjarjeve publike, si dhe për pjesëmarrjen në fushatë të kategorive të caktuara të punonjësve të institucioneve publike. Rregullave të fushatës u mungon qartësia se cilat aktivitete konsiderohen si fushatë e që janë të ndaluara për nëpunësit civilë kur veprojnë në cilësinë e tyre zyrtare, duke qenë qartazi në kundërshtim me standardet përkatëse ndërkombëtare.⁷ Ngjashëm, janë disa rregulla të rëndësishme të fushatës siç janë ato që kanë të bëjnë me njoftimin për ngjarjet politike që adresohen vetëm në rregulloret e KQZ-së. Edhe pse këto rregulla nuk janë tepër kufizuese, çështjet e tilla themelore që ndikojnë në të drejtën për të mbajtur tubim politik duhet të përcaktohen me ligj dhe nuk duhet t'i lihen KQZ-së që t'i rregullojë për çdo zgjedhje.

Subjektet politike në përgjithësi i respektojnë rregullat e fushatës të përcaktuara në kornizën ligjore. Gjobat që PZAP i ka aplikuar për subjektet politike kapin shumën e përgjithshme prej 257,350 EUR, një shumë dukshëm më e ulët krahasuar me ciklet e mëhershme zgjedhore. Shumica e gjobave kanë të bëjnë me shkelje të vogla që lidhen me vendosjen e materialeve zgjedhore në vendet ku ishte i ndaluar postimi i tyre ose për praninë e të miturve në fushatë dhe vetëm pak prej tyre lidheshin me gjuhën nxitëse ose me shkelje të tjera më të rënda. Shumë bashkëbisedues i kritikuan rregullat zgjedhore lidhur me përfshirjen e fëmijëve për mungesë të qartësisë.

⁷ Udhëzimet e përbashkëta për parandalimin dhe reagimin ndaj keqpërdorimeve të resurseve administrative gjatë proceseve zgjedhore, Komisioni i Venedikut dhe OSBE/ODIHR, 2016

Partitë politike nuk e kishin përfshirë pjesëmarrjen e grave në prioritetet e tyre gjatë fushatës. Gratë në përgjithësi ishin të nën-përfaqësuar në audiencë në ngjarjet e fushatës dhe kishin marrë mbështetje të kufizuar nga partitë e tyre për të garuar në zgjedhje. Programet zgjedhore të shumicës së subjekteve politike kanë ofruar detaje të kufizuara për politikën specifike për inkurajimin e angazhimit më të madh të grave në jetën publike.

Personat me aftësi të kufizuara ishin të nën-përfaqësuar në aktivitetet e fushatës ku qasja e tyre në ngjarjet e fushatës faktikisht ishte e kufizuar. Në programet zgjedhore të shumicës së subjekteve politike nuk përfshihej pothuaj asnjë detaj rreth politikave për lehtësimin e angazhimit publik të personave me aftësi të kufizuara në jetën publike. Për më tepër, shumica e subjekteve politike nuk kanë paraqitur kandidatë me aftësi të kufizuara për këto zgjedhje.

Raundi i parë i zgjedhjeve për kryetarë të komunave dhe për kuvende komunale, 22 tetor 2017

Në përgjithësi, atmosfera ishte e qetë dhe fushata ishte e profilit të ulët në zonat me shumicë shqiptare, me intensifikim të aktiviteteve gjatë javës së fundit para ditës së zgjedhjeve.

Fushata në zonat me shumicë shqiptare në masë të madhe u zhvillua në përputhje me kërkesat ligjore për zgjedhje dhe në përgjithësi garuesit ishin në gjendje të zhvillonin fushatën lirshëm. Megjithatë, vëzhguesit e EU EOM i përcollën rastet e izoluara të frikësimit të votuesve dhe kandidatëve në disa prej këtyre komuniteteve, përfshirë raportet se nëpunësit publikë, si mësimdhënësit dhe punëtorët shëndetësorë, ishin vënë nën presion për të mbështetur kandidatë të caktuar ose të cilëve u ishte pamundësuar pjesëmarrja në aktivitetet e fushatës. Në Malishevë, mësimdhënësve dhe nëpunësve të tjerët të institucioneve publike u ishte bërë presion jo vetëm që të mbështesin kandidatin e NISMËS por edhe që të heqin dorë nga të qenurit anëtarë në partitë tjera. Përveç kësaj, votuesit dhe një kandidat në komunitetin goran në Dragash i ishin nënshtruar trysnisë dhe frikësimit nga përfaqësuesit e të ashtuquajturit sistem paralel serb, me përfshirjen e Partisë Gorane të Bashkuar (JGP). Kjo veçanërisht preku nëpunësit që punonin në shkolla.

Ambienti i fushatës për raundin e parë të zgjedhjeve ishte shëmtuar nga një formë e thellë e frikësimit brenda shumicës së komuniteteve serbe të Kosovës, që kishin në shënjestër subjektet politike dhe votuesit që nuk ishin të Listës Serbe. Kjo e përfshiu presionin mbi kandidatë individual për tu tërhequr dhe e kufizoi konkurrencën politike, duke ngritur pikëpyetje për procesin e përgjithshëm demokratik në ato zona. Disa kandidatë të subjekteve politike që nuk ishin në Listën Serbe supozohet që janë tërhequr nga gara si rezultat i këtij frikësimi. Partitë kryesore opozitare, përfshirë SLS-në dhe PKS-në, nuk propozuan kandidatë për kryetarë komune në shumicën e komunave me shumicë serbe.⁸

EU EOM mori raporte se institucioneve që funksiononin në të ashtuquajturin sistem paralel të Serbisë në Klllokot dhe Ranillug ishin përfshirë në vënien nën presion dhe largimin nga puna të kandidatëve që nuk ishin në Listën Serbe dhe familjeve të tyre. Rastet më të rënda të frikësimit që përfshinin frikësimin e kandidatëve që nuk ishin të listës serbe shumë rrallë raportoheshin në sistemin e drejtësisë së Kosovës. Këto pretendime të përhapura rreth presionit dhe kërcënimeve të kandidatëve, të kombinuara me presionet dhe kërcënimet e votuesve, kishin ndikim negativ në fushatë në këto hapësira, duke shtuar mosbesimin ekzistues publik për procesin zgjedhor dhe ngritën shqetësime rreth aftësisë së votuesve për të krijuar opinionin e tyre dhe për t'i hedhur votat e tyre pa frikë nga

⁸ Ndodhën disa incidente të dhunshme, përfshirë djegien e veturave të Oliver Ivanoviqit dhe Dragiša Miloviqit në Mitrovicë (Veri) para fillimit të fushatës zyrtare.

ndëshkimi, që është në kundërshtim me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.⁹ Ambienti i fushatës ishte veçanërisht i tensionuar në veri, me incidente të dhunshme të përsëritura ku ishin të përfshirë anëtarë të PKS-së dhe Listës Serbe në Leposaviq.

Vëzhguesit e EU EOM-së morën raporte për keqpërdorimin e resurseve publike në një numër të kufizuar të rasteve në Viti, Klllokot dhe Zveçan. Shumë udhëheqës të njohur të subjekteve politike morën pjesë në fushatë duke iu ofruar përkrahje kandidatëve të tyre lokalë. Për më tepër, Kryeministri bëri fushatë krahas kandidatëve të AAK-së për postet e kryetarëve të komunave, duke premtuar financim të projekteve lokale nëse do të zgjidhen këta kandidatë të caktuar.

Raundi i dytë i zgjedhjeve për kryetar të komunës, 19 nëntor 2017

Ambienti politik në pjesën më të madhe të Kosovës pas ditës së zgjedhjeve për kuvendet komunale dhe raundit të parë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave ishte e qetë. Partitë politike i pranuan rezultatet por disa ngritën shqetësime rreth numrit të madh të fletëvotimeve të pavlefshme, pasaktësive në listat e votuesve, sjelljes së keqe të stafit të zgjedhjeve gjatë procesit të votimit dhe numërimit, votimit të asistuar, rasteve të blerjes së votës dhe presionit të vazhdueshëm mbi votuesit veçanërisht mbi komunitetet joshumicë.¹⁰

Fushata vazhdoi menjëherë pas ditës së zgjedhjeve, edhe pse në nivel më të ulët, kryesisht me aktivitete derë më derë dhe kontakte direkte me votuesit në lokacione private dhe duke pasur si cak grupe specifike të votuesve si gratë, të rinjtë dhe sipërmarrësit. Fushata zyrtare u zhvillua gjatë periudhës prej 13 deri më 17 nëntor 2017. Shumica e partive politike zhvilluan fushatë me resurse të kufizuara dhe u dhanë përparësi shpenzimeve në programe të sponsoruara televizive, posterë dhe në organizimin e ngjarje të vogla me votuesit. Garuesit patën mundësi të zhvillojnë fushatën lirshëm dhe përgjithësisht u përmbajtën nga përdorimi i gjuhës nxitëse. Shumica e subjekteve politike filluan fushatën me ngjarje të vogla dhe organizuan tubime vetëm në ditët e fundit me mesazhe për shëndetësinë, arsimin, papunësinë dhe infrastrukturën lokale. Sikurse në raundin e parë, mesazhet në fushatë ishin shumë të përgjithshme, pa dallime të mëdha ndërmjet garuesve përkatës dhe u mungonte përmbajtja rreth politikave.

EU EOM vërejti tensionim në disa komuna ku raundi i dytë ishte një garë e ngushtë, për shembull në Gjakovë dhe në Mitrovicë (Jugore) ku garuesit akuzuan njëri tjetrin për presion të paligjshëm mbi votuesit. Kryetari aktual i Mitrovicës (Jugore) akuzoi kundërshtaren e tij për metoda të padrejta të fushatës, përkundër faktit se të dy partitë garuese ishin anëtare të koalicionit qeverisës. Vëzhguesit e EU EOM u informuan se përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë si romët, goranët, ashkalitë dhe egjiptianët vazhduan të jenë subjekt i presionit dhe frikësimit. Në Prishtinë vëzhguesit vërejtën një retorikë politike agresive, ku dy kandidatët drejtuan akuza kundër njëri tjetrit në vend se të diskutonin përmbajtjen e politikave të tyre dhe platformave zgjedhore.

Garuesit në përgjithësi respektuan kriteret ligjore për fushatë. Megjithatë, vëzhguesit e EU EOM morën raporte të rasteve të blerjes së votave në Partesh dhe Gjakovë. Disa bashkëbisedues treguan se blerja e votës është bërë pjesë e pandashme e kulturës politike lokale, duke theksuar se marrja e parave ose përfitimeve të tjera në këmbim të votës arsyetohej me mungesën e mundësive të tjera, veçanërisht në komunitetet jo-shumicë si romët, egjiptianët dhe ashkalitë. Kjo ndikon në lirinë e

⁹ Udhëzimet e përbashkëta për parandalimin dhe reagimin ndaj keqpërdorimeve të resurseve administrative gjatë proceseve zgjedhore, Komisioni i Venedikut dhe OSBE/ODIHR, 2016

¹⁰ Siç raportohet nga vëzhguesit e BE-së, VAKAT vazhdoi të bëjë presion mbi votuesit që jetonin në komunitetet gorane.

votuesve për të krijuar një opinion, dhe është në kundërshtim me parimin e zgjedhjes së lirë në standardet evropiane dhe ndërkombëtare dhe mund të dëmtojë besimin e përgjithshëm të publikut në procesin zgjedhor.¹¹ EU EOM po ashtu mori raporte për keqpërdorimin e resurseve publike nga PDK në Klinë dhe nga LDK në Podujevë në një numër të kufizuar të rasteve. Pati pretendime se AAK kishte përdorur lëshimin e certifikatave të veteranëve të financuara me fonde publike për të ndikuar tek votuesit në Klinë, Istog dhe Rahovec.

Atmosfera në komunitetet me shumicë serbe të Parteshit dhe Kllokotit ishte e polarizuar por pa ndonjë incident të madh. Përfaqësuesit e IQ Narodna Sloga dhe të Listës Serbe në Partesh e akuzuan njëri tjetrin për akte të vazhdueshme të blerjes së votave dhe presionit mbi përkrahësit e tyre. Përkundër frikësimit të kandidatit për kryetar nga IQ e Kllokotit/ Verbovcit dhe përkrahësve të tij gjatë gjithë periudhës së fushatës, ai iu bashkua Listës Serbe pak para zgjedhjeve dhe pasi kishte marrë mbështetjen zyrtare nga udhëheqësit e saj. Kjo pati ndikim në garën politike e cila vazhdoi ndërmjet fraksioneve brenda Listës Serbe, përderisa të dy kandidatët intensifikuan përpjekjet e tyre për të bindur votuesit shqiptarë të Kosovës që të votojnë për ta.

FINANCIMI I FUSHATËS

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, Ligji për Financimin e Partive Politike Nr. 03/L-174 dhe disa rregullore të KQZ-së për financimin e fushatës përbëjnë kornizën ligjore që rregullon burimet e të ardhurave dhe shpenzimet e subjekteve politike.¹² Korniza ligjore synon të krijojë kushte të barabarta duke përcaktuar kufizime të shpenzimeve dhe kërkesa për raportim, procedura të auditimit dhe gjoba. Burimet e financimit të subjekteve politike janë fondet publike si dhe donacione nga individë dhe persona juridikë.

Ligji e rregullon ndarjen e fondeve publike për subjektet politike për fushatat zgjedhore ndërsa rregulloret e KQZ-së shtojnë dispozita më të hollësishme për kufizimet e shpenzimeve, për publikim dhe për procedurat e auditimit. I njëjti ligj i përcakton kriteret sipas të cilave 90 për qind e këtyre fondeve publike u ofrohen subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend, duke u bazuar në numrin e vendeve në legjislaturën e mëparshme, përderisa dhjetë për qind ndahen proporcionalisht nga subjektet tjera politike të regjistruara dhe të certifikuara nga KQZ për të marrë pjesë në zgjedhje. Kuvendi i Kosovës mund të ndajë fonde publike shtesë për fushatat zgjedhore të çdo subjekti politik, duke mos e kaluar 0.05 për qind të buxhetit. Që prej 2013, Kuvendi nuk u ka ndarë financim publik shtesë subjekteve politike. Për më tepër, ligji nuk përcakton kriteret për ndarjen e fondeve publike për subjektet politike që nuk janë të përfaqësuara në Kuvend. Mungesa e financimit publik shtesë për këto zgjedhje lokale i ka kufizuar opsionet e bërjes së fushatës, veçanërisht për partitë më të vogla dhe ato që përfaqësojnë komunitetet jo-shumicë.

Rregulla zgjedhore nr. 12/2013 e përcakton kufirin e shpenzimeve për secilin subjekt politik në 0.5 euro për votues të regjistruar, prandaj ajo ndryshon varësisht prej madhësisë së komunës. Ligji i sqaron më tej burimet e të ardhurave, duke përcaktuar maksimumin e donacionit prej gjithsej 2,000 euro në vit për personat fizikë dhe gjithsej 10,000 euro në vit për personat juridikë.

¹¹ Konventa Ndërkombëtare për Liritë Civile dhe Politike (KNLCP); *Komisioni i Venedikut, Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, raport shpjegues*, CDL-AD(2002)23rev

¹² Rregulla zgjedhore Nr. 12/2013 mbi Kufizimin e Shpenzimeve të Fushatës dhe Deklarimi Financiar dhe Rregulla Zgjedhore Nr. 14/2015 mbi Financimin e Subjekteve Politike dhe Sanksionet

Subjektet politike kanë deklaruar se kanë plane për të bërë fushata me buxhet të ulët për këto zgjedhje komunale dhe për kryetar komune. Vëzhguesit e EU EOM u informuan se partitë kryesore kishin shpenzuar shumicën e fondeve të fushatës në reklama politike dhe programe të sponsorizuara në media. Për dallim, informatat e marra nga organizatat e shoqërisë civile treguan se shumica e fondeve të fushatës ishin shpenzuar në ngjarje publike, në media online dhe në reklama në mediat sociale.¹³ Shumë kandidatë morën mbështetje financiare nga partitë e tyre, megjithatë, kostot e fushatës pjesërisht u mbuluan nga vet kandidatët, gjithashtu.

Në përputhje me Rregullën Zgjedhore 12/2013, çdo subjekt politik i certifikuar për të marrë pjesë në zgjedhje duhet të paraqesë, jo më vonë se 45 ditë pas ditës së zgjedhjeve, raportin e deklarimit financiar të fushatës i cili mbulon periudhën nga dita kur u shpallën zgjedhjet deri në ditën e zgjedhjeve.¹⁴ Raporti u dorëzua nga subjektet politike pranë Zyrës së KQZ-së për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim (ZRPPC). Standardet ndërkombëtare kërkojnë që raportet e financimit të fushatës të dorëzohen brenda një afati kohor prej jo më shumë se 30 ditë pas zgjedhjeve. Raportet e tilla duhet të kërkojnë jo vetëm për partinë si tërësi, por edhe për kandidatët individualë dhe listat e kandidatëve.¹⁵

Prej 2013, përgjegjësia për auditimin e raporteve i takon Kuvendit të Kosovës, i cili në mënyrë sistematike ka dështuar që të zgjedh auditorët, duke lënë kryesisht të pazbatuar kërkesën për transparencë dhe llogaridhënie. Raportet nga grupet e shoqërisë civile e kanë ndërlidhur këtë me mungesën e vullnetit politik të partive politike të përfaqësuara në Kuvend.¹⁶

Efekti potencial pozitiv i kuadrit ligjor ekzistues është dëmtuar nga fushëveprimi i kufizuar i rishikimit financiar. Kjo përkeqësohet nga praktikatat e brendshme të partive politike. Gjatë zgjedhjeve të mëhershme, shumica e partive nuk i publikuan raportet gjithëpërfshirëse të fushatës në faqet e tyre në internet, duke u thirrur në një dispozite ligjore që kërkon publikimin vetëm pasi që të jetë kryer auditimi. Në aspektin pozitiv, pas zgjedhjeve parlamentare të qershorit, subjektet politike si LDK dhe Vetëvendosje i publikuan raportet e tyre financiare në faqet e tyre të internetit, megjithëse pa dhënë informacione për donacionet e tyre. Mungesa e shqyrtimit perceptohet gjerësisht si problem nga organizatat e shoqërisë civile dhe ngritë pyetje rreth shpenzimeve përtej kufizimeve të përcaktuara me ligj, si dhe pranimin të donacioneve të paregjistruara, veçanërisht ato që u drejtohen kandidatëve individualë.

Në mungesë të monitorimit sistematik të financimit të fushatës nga institucionet të pavarura, siç janë organizatat e shoqërisë civile dhe mekanizmat efektivë për mbikëqyrje nga institucionet publike, është e vështirë të identifikohen mangësitë e raportimit financiar të fushatës dhe kërkesat ligjore për transparencë dhe llogaridhënie përgjithësisht mbesin të pazbatuara.¹⁷

¹³ Nuk kishte monitorim sistematik të financimit të fushatës për zgjedhjet komunale. Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ua ka shpërndarë subjekteve politike një pyetësor në fillim të fushatës, me pyetje për shpenzimet e tyre të planifikuara për fushatë.

¹⁴ Neni 3.2 i Rregullës zgjedhore Nr. 15/2013 për Zgjedhjet e jashtëzakonshme dhe të parakohshme.

¹⁵ Komisioni i Venedikut dhe OSBE/ODIHR, *Udhëzimet për rregullimin e partive politike, 2011*

¹⁶ Komisioni Evropian ka reflektuar për këto shqetësime në Raportin për Kosovën 2015, nën temën lufta kundër korrupsionit. Me 19 tetor Kuvendi zgjodhi auditorët dhe procesi i auditimit është duke vazhduar.

¹⁷ Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ua ka shpërndarë subjekteve politike një pyetësor në fillim të fushatës, me pyetje për buxhetin e tyre të planifikuar dhe ka marrë informata të kufizuara kthyesë të cilat nuk kanë kontribuar në rritjen e transparencës në raportim.

MEDIAT

Konteksti medial

Kosova ka një ambient pluralist dhe të gjallë mediatik. Burimet kryesore të informacionit janë televizioni së bashku me mediat online dhe ato sociale. Aktualisht ekzistojnë 71 kanale televizive dhe 83 radiostacione, të cilat transmetohen përmes rrjeteve tokësore ose kabllore. Transmetuesi publik, Radiotelevizioni i Kosovës (RTK), përbëhet nga katër kanale televizive dhe dy radiostacione. Përveç kanalit të parë televiziv publik, *RTK1*, janë edhe katër kanale televizive private të cilat kanë një audiencë të rëndësishme: *RTV21*, *Kohavisioni (KTV)*, *Klan Kosova* dhe *TV Dukagjini*.

Mediat online dhe ato sociale përfitojnë nga shtrirja e madhe e internetit në Kosovë dhe janë një burim i rëndësishëm i informacionit, sidomos për pjesët e të rinjve të shumtë të popullsisë. *Gazetaexpress.com* dhe *telegrafi.com* janë mediat më të popullarizuara të lajmeve online, derisa Facebook është media kryesore sociale. Aktualisht publikohen vetëm pesë media të shkruara, edhe pse me tirazh të kufizuar, ato kultivojnë debatin publik, veçanërisht gazeta më e respektuar ditore, *Koha Ditore*.

Konteksti medial në Kosovë mbetet i ndarë mes komuniteteve që flasin gjuhën shqipe dhe serbe. Kanali kryesor televiziv publik, *RTK1*, transmeton kryesisht në gjuhën shqipe, ndërsa *RTK2* transmeton në gjuhën serbe dhe në gjuhët tjera jo-shumicë përmes sistemit kabllor por nuk ka qasje në katër komunitet veriore. Komunitetet shumicë serbe të Kosovës thuhet se kryesisht mbështeten për informim tek transmetuesit lokalë në gjuhën serbe ose në kanalet kryesore televizive nga Serbia, të cilat janë lehtësisht të qasshme përmes rrjetit TV/kabllor.

Korniza ligjore për media dhe liria e mediave

Legjislacioni siguron një kuadër të shëndoshë për lirinë e medias. Kushtetuta e Kosovës e garanton “lirinë dhe pluralizmin e mediave” dhe e ndalon censurën. Shpifja dhe fyerja nuk janë penalizuar dhe korniza ligjore i përfshinë ligjet për mbrojtjen e burimeve të gazetarëve dhe dhënien e qasjes në informata publike.¹⁸ Asociacioni i Gazetarëve në Kosovë (AGK) dhe Shoqata e Gazetarëve të Serbisë në Kosovë (SHGSK) janë organet kryesore që i përfaqësojnë interesat e gazetarëve kosovarë.¹⁹ AGK është dëshmuar aktive edhe gjatë periudhës së zgjedhjeve.²⁰ Bashkëbiseduesit nga mediat raportuan se në përgjithësi kishin mundësi ta ushtrojnë profesionin e tyre lirshëm, por ende ndodhin kërcënime ndaj gazetarëve dhe pavarësisht nga korniza ligjore ekzistuese, hetimi dhe ndjekja penale e tyre nga gjyqësori është ndonjëherë e ngadalshme dhe joefektive.

Transmetuesi publik rregullohet me ligjin për Radiotelevizionin e Kosovës - RTK (2012). Anëtarët e bordit të RTK-së zgjedhen nga Kuvendi i Kosovës, që sipas bashkëbiseduesve të EU EOM e pengon

¹⁸ Ligji Civile kundër Shpifjes dhe Fyerjes (2012), Ligji për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarëve (2013), Ligji për Qasje në Informata Publike (2010).

¹⁹ Shoqata e Gazetarëve të Serbisë në Kosovë (UNS) është degë e Shoqatës së Gazetarëve të Serbisë.

²⁰ AGK i regjistroi katër kërcënime dhe sulme ndaj gazetarëve gjatë periudhës së zgjedhjeve, por asnjëra nuk kishte të bënte me raportimin për zgjedhjet. Me 20 nëntor 2017, AGK publikoi Raportin Vjetor: “Treguesit e nivelit të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve (Kosovë)”.

pavarësinë e tij të plotë nga ndikimet politike.²¹ Mediat elektronike private rregullohen me akte nënligjore të nxjerra nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), që është organ rregullator i mediave. Ligji për Komisionin e Pavarur për Media (2012) i përcakton përgjegjësitë e tij, që përfshijnë rregullimin e frekuencave të transmetimit, lëshimin e licencave për transmetuesit publikë dhe privatë, krijimin dhe zbatimin e politikave të transmetimit si dhe sanksionimin e transmetuesve që nuk e respektojnë ligjin. Shtatë anëtarët e KPM-së dhe tre gjyqtarët e Bordit të Ankesave emërohen nga Kuvendi i Kosovës. Aktualisht është një pozitë e lirë në Bordin e Ankesave. Duke marrë parasysh se vendimet e Bordit të Ankesave duhet të merren me shumicën e votave, emërimi me vonesë i gjyqtarit të tretë nga Kuvendi i Kosovës mund të rrezikojë kapacitetin e KPM-së që të marrë vendime përfundimtare dhe të përmbush detyrat dhe përgjegjësitë e tij.

Mediat e shkruara dhe mediat e lajmeve online nuk kanë nevojë për licencë për të vepruar. Lulëzimi i mediave të lajmeve online u shoqërua me disa sfida, përfshirë nivelin e profesionalizmit të tyre dhe mungesën e transparencës së pronësisë së tyre, gjë që shpesh e bën të vështirë që ato të mbahen përgjegjëse për përmbajtjen e publikuar. Që nga viti 2005, mediat e shkruara e kanë miratuar vullnetarisht një Kod të Sjelljes së shtypit dhe e kanë krijuar Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK) si trupin e tyre vetë-rregullues. Kohëve të fundit, duke e bërë vetë-rregullimin e tyre, disa media online iu bashkuan Këshillit të Mediave të Shkruara dhe tani përbëjnë shumicën e anëtarëve të tij.²²

Rregullimi i fushatës mediale

LZP po ashtu e rregullon edhe sjelljen e mediave gjatë zgjedhjeve lokale. Mediat elektronike rregullohen më tej me Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave, me udhëzimet e KPM-së bazuar në Kapitullin VIII të LZP-së dhe Rregulloren e KPM-së për komunikimet audiovizive komerciale.

Ligji për zgjedhjet dhe rregullorja lidhur me mediat kërkojnë, mes tjerash, që të gjitha mediat të sigurojnë mbulim të drejtë dhe të barabartë të të gjithë garuesve në zgjedhje. Reklammat me pagesë lejohen pa ndonjë kufizim specifik për garuesit, edhe pse transmetuesit nuk duhet të ndajnë më shumë se 20 për qind të kohës së shikueshmërisë më të lartë për reklama komerciale, përfshirë edhe spotet politike me pagesë.²³ Përveç kësaj, ato duhet të sigurojnë kushte të barabarta për të gjithë garuesit dhe çmimi i kërkuar nuk duhet ta kalojë normën më të ulët për të njëjtën 'kohë dhe ditë të javës' që është aplikuar në gjashtë muajt paraprak. Transmetuesit të cilët pranojnë reklama me pagesë detyrohen të ofrojnë kohë minimale të transmetimit falas për të gjitha subjektet politike të regjistruara për t'i përcjellë mesazhet e tyre, por mund të vendosin kur dhe në çfarë formati t'u mundësojnë atyre qasjen falas.²⁴ Transmetuesit duhet t'ia dorëzojnë në baza javore një 'ditar' KPM-së me orarin e reklamave të paguara dhe kohën e lirë të transmetimit që i kushtohet secilit subjekt politik të certifikuar.

²¹ Komisioni i Kuvendit të Kosovës për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media e informoi EU EOM-në se është duke zhvilluar diskutime për rishikimin e Ligjit të tanishëm për Radiotelevizionin e Kosovës RTK (2012), dhe kryesisht për të modifikuar financimin e buxhetit të RTK-së.

²² Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës aktualisht përbëhet nga katër media të shkruara dhe 24 media të bazuara në internet.

²³ TV dhe radiostacionet publike nuk mund të ndajnë më shumë se 10 për qind të programeve të tyre ditore për reklama komerciale.

²⁴ Vetëm transmetuesit, si publikë ashtu edhe privatë, që vendosin të transmetojnë reklama me pagesë, janë të obliguar të ofrojnë ca kohë transmetimi me pagesë. Televizioni dhe radiostacionet publike duhet t'i ofrojnë së paku 40 dhe 30 minuta përkatësisht, secilit garues, ndërsa transmetuesit privatë duhet të ofrojnë një numër tjetër minimalë të minutave të transmetimit pa pagesë bazuar në mbulueshmërinë gjeografike të transmetuesit. Gjatë periudhës së monitoruar, kanalet

KPM, e cila është përgjegjëse për të mbikëqyr se sa mediat respektojnë zgjedhjet dhe rregulloret e tjera lidhur me mediat, i ka monitoruar mediat elektronike gjatë gjithë periudhës së zgjedhjeve. Gjatë periudhës para raundit të parë, KPM kishte vërejtur shkelje të ligjit në 12 nga 25 kanalet televizive të monitoruara, përderisa para raundit të dytë, KPM vërejtë shkelje të bëra në shtatë transmetues. Shumica e shkeljeve që ishin vërejtur edhe në zgjedhjet e mëhershme dhe që kishin të bënin me rregullat mbi transmetimin e spoteve politike me pagesë, përfshirë praninë e fëmijëve, dështimin për të ofruar mbulueshmëri të drejtë dhe të balancuar dhe për respektimin e periudhës së heshtjes zgjedhore, rezultuan me gjopa për transmetuesit.

KPM as nuk doli me ndonjë deklaratë publike për t'iu përkujtuar transmetuesve rregullat për mbulimin e zgjedhjeve para e as gjatë periudhës së zgjedhjeve, e as nuk i sanksionoi shkeljet e ligjit me kohë pasi që nuk mbajti asnjë takim për të diskutuar shkeljet gjatë fushatës zgjedhore njëmuajore për raundin e parë. Vendimet që adresojnë mbulueshmërinë nga mediat të fushatave zgjedhore të raundit të parë dhe të dytë u publikuan më shumë se dy javë pas dy ditëve të zgjedhjeve. Për më tepër, në disa raste KPM nuk mori vendime konsistente për shkelje të ngjashme të vërejtura në stacione të ndryshme televizive, dhe nuk adresoi disa shkelje, që ishin vërejtur nga monitorimi i mediave nga EU EOM, siç janë sponsorizimi i programeve për ngjarjet aktuale dhe prania e spoteve politike me pagesë në ndërprerjet komerciale të emisioneve të lajmeve. Këto shkelje kontribuan në zbehjen e vijave ndërmjet përmbajtjes redaktuese dhe materialit me pagesë, në dëm të publikut.

Monitorimi i mediave nga EU EOM

Mediat kryesore elektronike ofruan një mbulueshmëri të madhe të garës zgjedhore, nuk përdorën mesazhe nxitëse dhe mbuluan fushatën zgjedhore formate të ndryshme, përderisa shumica e mediave elektronike lokale ofruan mbulim të kufizuar të zgjedhjeve. Në pajtim me ligjin, transmetuesi publik i transmetoi spotet edukative të votuesve të ofruara nga KQZ-ja pa pagesë në kanalën e parë televiziv *RTK1* në gjuhën shqipe si dhe në kanalën e dytë televiziv *RTK2* në gjuhën serbe dhe në gjuhët jo-shumicë.²⁵

Ngjashëm, mediat e lajmeve online mbuluan gjerësisht fushatën e zgjedhjeve lokale, dhe disa faqe të lajmeve në internet krijuan seksione *ad hoc* për zgjedhjet. Megjithatë, shumica e mbulueshmërisë nga mediat online u bazua në informatat e mbledhura nga agjencitë e lajmeve dhe burimet e tjera mediatike dhe nuk ishte rezultat i raportimit profesional të gazetarëve. Disa media të lajmeve online shfaqën anim redaktues kah ose kundër partive politike dhe kandidatëve. Mediat sociale kryesisht u përdorën nga mediat tradicionale dhe mediat online për të shpërndarë regjistrime në kohë reale (live) të debateve dhe ngjarjeve të fushatës.²⁶

Raundi i parë

tevizive, përfshirë televizionin publik *RTK1* dhanë qasje në hapësirë transmetuese pa pagesë, por në përgjithësi pati interesim të kufizuar të garuesve për ta shfrytëzuar këtë mundësi. Janë vërejtur vetëm një numër shumë i izoluar i ankesave të garuesve për mos ofrim të qasjes në hapësirë transmetuese pa pagesë.

²⁵ *RTK2* nuk është e qasshme në komunat veriore me shumicë serbe, të cilat nuk përfituan nga spotet e KQZ-së për edukimin e votuesve.

²⁶ Analizimi i pesë faqeve më të popullarizuara në Facebook të mediave online tregoi se përmbajtja lidhur me zgjedhjet e postuar në këto faqe nxitë një angazhim mjaft të kufizuar të përdoruesve të mediave sociale krahasuar me postimet që nuk lidheshin me zgjedhjet. Nga përmbajtjet lidhur me zgjedhjet, videot direkte (live) në Facebook të ngjarjeve të fushatës dhe debateve zgjedhore ishin formati që nxitë angazhimin më të madh të publikut. Me “angazhim” i referohemi numrit të përgjithshëm të ndërveprimeve, siç janë ‘pëlqimet’, komentet dhe shpërndarjet e bëra nga përdoruesit.

Mbulimi i fushatës zgjedhore në lajme nga mediat elektronike u fokusua në partitë politike të përfaqësuara në Kuvend, ku partitë më të vogla dhe kandidatët e pavarur pothuaj mungonin nga mbulueshmëria e fushatës.²⁷ Kanali televiziv publik *RTK1* ofroi një mbulueshmëri mjaft të drejtë dhe me ton neutral, duke ia dedikuar LDK-së 17 për qind, PDK-së dhe Vetëvendosjes 16 për qind secilës dhe AAK-së 14 për qind të mbulueshmërisë në lajme të subjekteve politike dhe institucionale në kohën e shikueshmërisë më të madhe. Kanalet televizive private të monitoruara ofruan mbulim mjaft të balancuar në lajme të LDK-së, PDK-së, Vetëvendosjes dhe AAK-së me mbulim më të kufizuar në lajme të AKR-së dhe NISMËS. Dy kanalet televizive private, *KTV* dhe *TV Dukagjini*, ofruan mbulueshmëri të konsiderueshme në lajme të Kryeministrit dhe udhëheqësit të AAK-së derisa kryente aktivitetin e tij institucional.²⁸

Në aspektin pozitiv, të gjitha kanalet televizive kryesore të monitoruara organizuan debate zgjedhore gjithëpërfshirëse me kandidatë për kryetar të komunës për shumicën e komunave, duke u dhënë mundësi kandidatëve të prezantohen, si dhe duke u mundësuar votuesve të bëjnë zgjedhje të informuar. Sidoqoftë, kandidatët shpenzuan një pjesë të rëndësishme të debateve zgjedhore duke sulmuar kundërshtarin në vend se të paraqesin dhe diskutojnë platformat e tyre. Duke pasqyruar fushatën e profilit të ulët në komunat me shumicë serbe, pati një mbulueshmëri shumë të kufizuar në lajme të këtyre garave për kryetarë të komunave në mediat elektronike të monitoruara dhe asnjëra prej tyre nuk ia doli të organizojë debate zgjedhore ndërmjet kandidatëve për kryetar të komunës.

Përveç spoteve reklamuese politike me pagesë dhe të rregulluara në mënyrë të rreptë, veçanërisht në dhjetë ditët e fundit të fushatës zgjedhore, partitë kryesore politike zhvilluan fushatë të gjerë në TV duke shfrytëzuar një zbrazëti në ligj, e cila u mundësonte kanaleve televizive të transmetojnë programe të sponsorizuara pa kufizim.²⁹ Për më tepër, duke shkelur ligjin në disa raste një kanal televiziv transmetoi spote politike me pagesë gjatë ndërprerjeve komerciale të emisioneve të lajmeve, ndërsa kanalet e tjera televizive transmetuan intervista të sponsorizuara ose material tjetër të sponsorizuar gjatë programeve të tyre për aktualitetet.³⁰ Monitorimi i mediave nga EU EOM po ashtu vërejti shkelje të tjera të ligjit lidhur me spotet politike me pagesë dhe respektimin e periudhës së heshtjes zgjedhore.

Përkundër numrit shumë të vogël të grave që garuan në zgjedhjet lokale, mediat elektronike bënë përpjekje pozitive të ftojnë në programet e tyre gratë candidate për pozitën e kryetareve të komunës dhe për kuvendet komunale. Sidoqoftë, vetëm *RTV21* përfshiu barazinë gjinore në të gjitha diskutimeve në debatet e veta zgjedhore.

Raundi i dytë

²⁷ EU EOM monitoroi dy kanale televizive publike (*RTK1*, *RTK2*) dhe katër kanale televizive private (*RTV 21*, *KTV*, *Klan Kosova* dhe *TV Dukagjini*) çdo ditë nga 17:00 deri në 01:00, si dhe kohën e shikueshmërisë më të lartë të lajmeve të TV Most dhe TV Puls dhe një mostër të mediave të lajmeve online.

²⁸ Shih Shtojcat për rezultate të detajuara të monitorimit të mediave.

²⁹ Gjatë dhjetë ditëve të fundit të fushatës zgjedhore, kanali televiziv privat *KTV* ia dedikoi 44 për qind dhe 3 për qind të mbulueshmërisë politike dhe të zgjedhjeve programeve të sponsorizuara, përkatësisht reklamimit me pagesë. Kanali televiziv privat *Klan Kosova* ia dedikoi 30 dhe 5 për qind respektivisht programeve të sponsorizuara dhe reklamimit me pagesë. Kanali televiziv publik *RTK1* i ka dhënë më pak hapësirë materialeve me pagesë se sa të gjitha kanalet televizive private: 16 për qind të programeve të sponsorizuara dhe 1 për qind të reklamimit me pagesë.

³⁰ Në disa raste, *RTV 21* transmetoi spote politike me pagesë gjatë ndërprerjeve komerciale në emisionet e tij të lajmeve, derisa *TV Dukagjini* dhe *Klan Kosova* transmetuan material të sponsorizuar në programet e tyre për ngjarjet aktuale.

LZP i cili po ashtu e rregullon edhe sjelljen e mediave gjatë zgjedhjeve lokale, aplikohet vetëm gjatë fushatës zgjedhore zyrtare. Në periudhën nga 23 tetori deri me 12 nëntor, transmetuesit e monitoruar ofruan mbulim të kufizuar në lajme të temave lidhur me zgjedhjet, të cilat kryesisht u fokusuan në publikimin dhe komentimin e rezultateve të zgjedhjeve dhe me lidhjen e koalicioneve zgjedhore për raundin e dytë. Disa kanale televizive private filluan të organizojnë debate zgjedhore si dhe intervista të drejtpërdrejta me garuesit e raundit të dytë menjëherë pas ditës së zgjedhjeve në raundin e parë.

Gjatë fushatës zgjedhore pesëditore për raundin e dytë, nga 13 deri me 17 nëntor, televizioni publik *RTKI* dhe mediat audiovizuale private të monitoruara ofruan mbulim mjaft të balancuar dhe neutral të partive politike dhe kandidatëve.³¹ Një përjashtim ishte mbulimi më i gjerë në lajme që mori Vetëvendosje në kanalet televizive private *KTV* dhe *TV Dukagjini*, për shkak të një ngjarjeje që nuk kishte të bënte me zgjedhjet e cila ndodhi në fund të fushatës zgjedhore.³² Shumica e mbulimit me lajme të zgjedhjeve për kryetarë të komunave, 72 për qind, u fokusua në garën për pesë komuna nga 20.³³ Çka është pozitive, *RTKI* dhe transmetuesit kryesor privat u mundësuan kandidatëve të përcjellin mesazhet e tyre duke organizuar disa debate zgjedhore për secilën komunë. Ndërmjet dy raundeve, të gjithë kandidatët morën pjesë në të paktën një deri në disa debate zgjedhore, me përjashtim të garuesve në komunat me shumicë serbe, të cilët nuk morën pjesë në asnjë debat. Gjatë fushatës zgjedhore për raundin e dytë, partitë politike kryesore vazhduan të përfitojnë nga zbrazëtitë ligjore që u mundësuan atyre të blejnë numër të pakufizuar të programeve të sponsorizuara. Domethënë, Vetëvendosje bleu 44 për qind të programeve të përgjithshme të sponsorizuara në të gjithë transmetuesit e monitoruar, e pasuar nga PDK e cila bleu 29 për qind dhe LDK me 20 për qind.

ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

Zgjedhjet e lokale u administruan nga një strukturë me tri nivele, që përbëhej nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), 38 Komisione Komunale Zgjedhore (KKZ) dhe 2,505 Këshilla të Vendvotimeve (KVV).

KQZ është organ i përhershëm i pavarur i përbërë nga njëmbëdhjetë anëtarë. Kryesuesi/ja e tij emërohet nga Presidenti i Kosovës nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme. Dhjetë anëtarët e tjerë të KQZ-së emërohen përmes propozimit nga grupet parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, përfshirë edhe ata që mbajnë ulëset e garantuara për komunitetet jo-shumicë.

Valdete Daka u emërua kryetare e KQZ-së me 16 qershor 2010 dhe mandati i saj i parë shtatëvjeçar skadoi gjatë zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, i cili nuk u vazhdua edhe për një mandat të dytë të plotë, por vetëm përmes një vazhdimi të përkohshëm. Me 15 qershor 2017, zyra ligjore e Presidentit ia zgjati mandatin deri në 90 ditë pas certifikimit të zgjedhjeve parlamentare. Meqë zgjedhjet parlamentare u certifikuan me 8 korrik, ky vazhdim i parë i mandatit ishte i vlefshëm deri me 6 tetor. Zyra e Presidentit theksoi se duke marrë parasysh procesin që ishte në vazhdim e sipër

³¹ EU EOM gjatë fushatës për raundin e dytë të zgjedhjeve monitoroi dy kanale televizive publike (*RTKI*, *RTK2*) dhe katër kanale televizive private (*RTV 21*, *KTV*, *Klan Kosova* dhe *TV Dukagjini*) çdo ditë nga 17:00 deri në 01:00, dhe një mostër të mediave të lajmeve online dhe faqet e Facebook-ut. .

³² Vendimi për dënimin e katër anëtarëve të Vetëvendosjes i shpallur në ditën e fundit të fushatës zgjedhore për një procedurë gjyqësore që kishte filluar në gusht 2016, tërhoqi vëmendje të madhe të disa mediave.

³³ Prishtina 24 për qind, Mitrovica (Jugore), dhe Gjakova 14 për qind secila, Gjilani 12 për qind dhe Ferizaj 8 për qind. Gara për kryetar të Prizrenit, komunës së dytë më të madhe të Kosovës, mori vetëm 4 për qind të mbulueshmërisë në lajme në të gjithë transmetuesit e monitoruar.

për zgjedhjet komunale dhe për kryetarë të komunave, ky vazhdim automatik u aplikua edhe për herën e dytë deri në 90 ditë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve lokale. Vazhdimi i mandatit pas certifikimit të zgjedhjeve lokale u aplikua edhe për anëtarët e tjerë të KQZ-së mandati i të cilëve përndryshe është i lidhur me mandatin e Kuvendit. Pozita e anëtarit të KQZ-së që përfaqëson komunitetin serb të Kosovës mbeti e lirë për një muaj kur Z. Nenad Rikalo dha dorëheqje për shkak të emërimit si Ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Z. Stevan Veselinović, i propozuar nga Lista Serbe, dha betimin para Presidentit me 10 tetor si anëtar i KQZ-së.

Takimet e KQZ-së ishin të hapura për vëzhguesit, publikun dhe mediat. Për shumicën e çështjeve, mjafton një shumicë e thjeshtë e votave për miratimin e vendimeve me një kuorum prej së paku shtatë anëtarësh të pranishëm. Për çështje të rëndësishme siç është miratimi i rregulloreve të KQZ-së, regjistrimi dhe certifikimi i subjekteve politike dhe shpallja e rezultatit të zgjedhjeve, KQZ-ja përpiket që të vendosë me konsensus. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë nevojitet një shumicë prej dy-të-tretës së votave. Në praktikë, KQZ ka miratuar shumicën e vendimeve të saj si trup kolegjal; megjithatë, ka pasur disa debate kontestuese për procesin e balotazhit në garat me rezultat të ngushtë, gjatë të cilave disa anëtarë të KQZ-së shkëmbyen akuza për mbështetjen e interesave të një subjekti të caktuar politik.

KQZ u përpoq t'i jap publikut dhe palëve të interesuara informata me kohë rreth procesit zgjedhor në faqen e internetit të KQZ-së duke synuar të ketë një nivel të lartë të transparencës. Megjithatë, Sekretariati i KQZ-së herë pas here dështoi të publikonte vendimet e fundit në faqen e internetit të KQZ-së, veçanërisht në gjuhën serbe.

Pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të qershorit, KQZ miratoi një Plan të Veprimit duke u bazuar në Rekomandimet e Përkohshme të EU EOM, të cilat sugjeronin që të bëhen përmirësimet që nuk kërkonin ndryshime në kornizën ligjore për administrimin e zgjedhjeve lokale 2017. KQZ e ka përmirësuar Doracakun e Procedurave të Votimit dhe Numërimit, duke thjeshtësuar formularët e rezultateve, duke e përmirësuar trajnimin e KVV-ve dhe duke aplikuar masa në QNR për rritjen e transparencës dhe saktësisë së operacioneve të saj.

KQZ nuk e ka realizuar plotësisht fushatën e saj për informimin e votuesve, duke theksuar problemet me procesin e prokurimit. Para raundit të parë KQZ kishte bërë një fushatë dhjetë ditore për informimin e votuesve me videospote të transmetuara në mediat kryesore elektronike që sqaronin se si duhet shënjuar dy fletëvotimet me qëllim të minimizimit të numrit të konsiderueshëm të fletëvotimeve të pavlefshme që janë vërejtur në zgjedhjet e mëhershme. Megjithatë, kjo përpjekje u bënë shumë vonë dhe pa e vënë në shënjestër elektoratin me mesazhe të ndryshme dhe me kanale efektive të komunikimit. Numri i fletëvotimeve të pavlefshme dhe të zbrazëta gjatë zgjedhjeve për kuvend të komunës mbeti i lart me 8.7 për qind, që paraqet vetëm një përmirësim të vogël nga 10 për qind sa ishte në zgjedhjet e mëhershme për kuvende komunale në vitin 2013. Në përgjithësi, fushata për informimin e votuesve ishte e pamjaftueshme, duke i lënë pa adresuar disa aspekte të procesit zgjedhor.

Një informatë e rëndësishme specifike për votuesit dhe këshillat e vendvotimeve rreth dokumenteve të identifikimit që ishin të pranueshme për identifikimin e votuesve në ditën e zgjedhjeve që e adresoi KQZ ishte shumë me vonesë dhe pa udhëzime të qarta. KQZ publikoi dy udhëzime me 18 tetor 2017,

i pari për votuesit që janë në listën e rregullt të votuesve³⁴ dhe i dyti për votuesit që votojnë me kusht.³⁵ Megjithatë, KQZ dështoi që të ofrojë sqarime mbi pranimin e dokumenteve të identifikimit të Serbisë për identifikimin e votuesve në ditën e zgjedhjeve. Pasi që kjo çështje nuk u sqarua si duhet para trajnimit të KVV-ve dhe doracakut i votimit paraqiste shembuj vetëm të dokumenteve të identifikimit të lëshuara nga Kosova ose UNMIK-u, pjesëmarrësit në trajnim në disa raste ishin të keqinformuar dhe kishin përshtypje se vetëm këto mund të përdoren për identifikimin e votuesve, edhe pse nuk ekziston asnjë kufizim ligjor.

Trajnimi i stafit të zgjedhjeve ishte i përgatitur dhe zhvilluar mirë me qëllimin kryesor të krijimit të aftësive praktike përmes ushtrimeve simuluese interaktive që adresonin të metat kryesore të hasura në ditën e zgjedhjeve, siç janë numërimi i votave, plotësimi i formularëve të rezultateve dhe procedurat e paketimit. Megjithatë, EU EOM vërejti se kohëzgjatja e trajnimit të stafit zgjedhor nuk ishte e mjaftueshme dhe se kishte mungesë të trajnimit të specializuar për kryesuesit e KVV-ve dhe për ekipet mobile për votimin e personave me nevoja të veçanta. Numri i madh i rinumërimeve në zgjedhjet për kuvendet komunale tregon problemet e vazhdueshme në performancën e KVV-ve lidhur me numërimin dhe plotësimin si duhet të formularëve të rezultateve në numërimin e fletëvotimeve më të komplikuar, i cili përfshin preferencat e kandidatëve. KKZ-të ishin më me përvojë, të organizuara më mirë dhe në gjendje të respektojnë afatet kohore lidhur me operacionet zgjedhore në komunat e tyre përkatëse. Pasi që KKZ-të për zgjedhjet lokale ishin emëruar para certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve parlamentare 2017,³⁶ KQZ-së iu desh të bazojë propozimet për KKZ në rezultatet e zgjedhjeve të vitit 2014 nga subjektet politike të përfaqësuara në Kuvendin e mëparshëm duke marrë parasysh edhe subjektet politike me rezultate të mira në zgjedhjet për kuvende komunale dhe partitë e komuniteteve jo-shumicë që gëzojnë përkrahje relevante në komunë.

Emërimi i (2,505) KVV-ve dhe i kryesuesve të tyre ishte një proces kompleks. KVV-të përbëheshin zakonisht nga pesë deri në shtatë anëtarë. Mekanizmi për themelimin e KVV-ve iu dha të drejtë për propozime subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës dhe subjekteve politike me ulëse në Kuvendin Komunal përkatës për të cilin po mbaheshin zgjedhjet. Një subjekti politik i lejohej të ketë një anëtar në KVV kështu që KQZ caktoi kuota për numrin e anëtarëve të KVV-së, anëtarëve rezervë dhe kryesuesve për secilin subjekt politik në secilën komunë. Çështja kryesore ishte që të ndahet barabartë numri i kryesuesve të KVV-ve ndërmjet katër subjekteve politike që kishin marrë më së shumti vota në zgjedhjet parlamentare të vitit 2017 në komunën përkatëse. KQZ miratoi kuotat për numrin e kryesuesve të KVV-ve duke pasur kështu një qasje gjithëpërfshirëse dhe të balancuar për përbërjen e KVV-ve në të gjitha komunat duke inkorporuar subjekte të ndryshme politike garuese që përfaqësonin komunitetin serb të Kosovës dhe komunitetet e tjera jo-shumicë.

Për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave, KQZ emëroi anëtarët e KVV-ve duke caktuar numër të barabartë të pozitave të kryesuesit për dy subjektet politike garuese në secilën komunë të cilat shkuan në balotazh. Sa i përket pozitave të anëtarëve të tjerë të KVV-ve, subjektet

³⁴ Neni 90 i LZP-së i përcakton si dokumente të pranueshme kartën e vlefshme e dokumentit të identifikimit personal (Letërnjoftimin), dokumentin e vlefshëm të udhëtimit, pasaportën e vlefshme, lejen kosovare të vozitjes ose kartelën e vlefshme të refugjatit dhe udhëzimi i KQZ-së i shtoi si të pranueshme edhe dokumentet e skaduar të UNMIK-ut.

³⁵ Udhëzimi i KQZ-së theksoi se vetëm dokumentet e identifikimit të lëshuara nga Kosova duhet të jenë të pranueshme për votuesit me kusht edhe nëse ata nuk gjenden në listën përfundimtare të votuesve të komunës.

³⁶ Zgjedhjet lokale u shpallën me 21 qershor dhe emërimi i KKZ-ve u bë me 3 korrik, ndërsa rezultatet e zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës u certifikuan me 8 korrik 2017.

politike kishin të drejtë të konfirmojnë ose zëvendësojnë stafin e tyre nga raundi i parë. Disa parti politike i zëvendësuan anëtarët e tyre në KVV në përputhje me rrethanat.

KQZ bëri përpjekje të verifikojë kualifikimin e 19,560 personave të propozuar për KVV. Divizioni i Shërbimit të Votuesve (DSHV) verifikoi se a ishin ata të regjistruar si votues në komunat e tyre përkatëse. PZAP iu përgjigj me shpejtësi kërkesës për verifikim duke i dhënë KQZ-së një listë prej tridhjetë personave të cilëve nuk u lejohej të emërohen si staf administrativ në zgjedhje për shkak të dënimeve të tyre të mëhershme nga PZAP. Megjithatë, Sekretariati i KQZ-së nuk ishte në gjendje të kontrollojë kërkesën për kualifikimin e personave të propozuar për KVV se nuk duhet të kenë qenë të dënuar për vepër penale në tri vitet e fundit me vendim të plotfuqishëm të gjykatës.³⁷ Edhe pse emrat e të gjithë kandidatëve të propozuar për staf në vendvotime i ishin dërguar me kohë Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorit të Shtetit për të verifikuar të kaluarën penale të tyre para emërimit të anëtarëve të KVV-ve, KQZ nuk mori asnjë përgjigje, duke treguar kështu një mungesë të mekanizmave të verifikimit.

Shkalla e përfaqësimit të grave brenda administratës së zgjedhjeve ka mbetur shumë e ulët. Prej 11 anëtarëve të KQZ-së, vetëm kryesuesja ishte grua, dhe gratë përfaqësonin vetëm 10.5 për qind të anëtarëve dhe kryesuesve të KKZ-ve. Pjesa e grave në mesin e anëtarëve të emëruar të KVV-ve ishte 26 për qind, e cila me përjashtim të Mitrovicës (Veriore) dhe Prishtinës, ishte shumë nën synimin prej 40 për qind të deklaruar nga partitë politike kryesore.

REGJISTRIMI I VOTUESVE

Kosova ka një sistem pasiv të regjistrimit të votuesve, ku gjenerohet lista e votuesve për secilën palë zgjedhje bazuar në të dhënat në regjistrin civil. Sipas nenit 5 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) një person ka të drejtë vote nëse ai/ajo është 18 vjeç apo më i vjetër në ditën e zgjedhjeve dhe e plotëson së paku një nga kushtet e mëposhtme:

- Është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil.
- Nëse banon jashtë Kosovës ose e ka lëshuar Kosovën në apo pas 1 janarit 1998, me kusht që t'i plotësojë kriteret e parapara sipas ligjit në fuqi për të qenë shtetas i Kosovës.
- Ka fituar statusin e refugjatit, siç është përkufizuar në Konventën lidhur me Statusin e Refugjatëve, në apo pas 1 janarit 1995, dhe ka të drejtë për t'u regjistruar në Regjistrin Qendror Civil si banor rezident i Kosovës.

Lista votuese krijohet nga Agjencia e Regjistrimit Civil të Kosovës (ARC) në bazë të një regjistri që përmban të gjithë kosovarët të cilëve u është lëshuar një dokument identifikues i Kosovës, si dhe rreth 140.000 mbajtës të dokumenteve të identifikimit të UNMIK-ut. Bazuar në të dhënat nga regjistri civil, lista përfundimtare e votuesve e vërtetuar nga KQZ-ja më 22 shtator 2017 përmbante 1,890,952 votues, që është një rritje prej 18,011 që nga zgjedhjet e qershorit.

Votuesit kishin mundësi të mjaftueshme për t'i kontrolluar shënimet e tyre në listën e votuesve dhe të kërkojnë ndryshime. Lista paraprake e votuese ishte në dispozicion të publikut në KKZ dhe në të gjitha komunat nga 26 korriku deri më 12 shtator, si dhe në faqen e internetit të KQZ-së. Gjatë kësaj periudhe, 8,218 votues kërkuar të ndryshonin vendet e tyre të votimit (4,741 kërkesa në KKZ-të, 3,477 kërkesa në internet). Nga këto kërkesa janë miratuar 7,409 dhe 809 janë mohuar. Në rast se një

³⁷ Neni 75.3 f i LZP-së dhe Neni 5.3.h i rregullës zgjedhore 9/2013

kërkesë për ndryshim u mohua, votuesit kishin mundësinë për t'i kontestuar vendimet e administratës zgjedhore nga data 29 gusht deri më 12 shtator. Garuesit në zgjedhje dhe organizatat e akredituara vëzhguese mund të merrnin një kopje të listës së votuesve për të kontrolluar saktësinë e tyre.

Prania e personave të vdekur në listën e votuesve është përmendur vazhdimisht nga bashkëbiseduesit e EU EOM si një mangësi e madhe që kontribuon në një besim të ulët publik në saktësinë e saj. EU EOM mori një kopje të listës paraprake të votuesve, siç parashihet me nenin 8.5 të LZP-së. Analiza e listës paraprake të votuesve zbuloi se ajo përmbante një numër të pabesueshëm të personave të moshës mbi 100 vjet (njëqindvjeçarë). Bazuar në listën paraprake të votuesve, Kosova ka 163 njëqindvjeçarë në 100,000 njerëz, 20 herë më shumë se mesatarja botërore e vlerësuar nga OKB në vitin 2015 në 7.4 për 100,000 njerëz. Përveç kësaj, në shumicën e komunave, lista paraprake e votuesve përmban një përqindje më të lartë të njerëzve të moshës 65 vjeçare apo më të vjetër se në vlerësimet e përgjithshme të popullsisë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. Në nëntë komuna numri i votuesve të moshës 65 vjeçare apo më të vjetër është mbi 20 për qind, që është një shifër gati e pamundur.

Personat e vdekur nuk janë hequr nga lista e votuesve me kohë për shkak të mangësive në procedurat për regjistrimin e vdekjeve. Shumë familje nuk i raportojnë vdekjet, pasi me sa duket vazhdojnë të marrin përfitimet sociale të të ndjerit. Përveç kësaj, nuk kërkohet certifikatë e vdekjes për varrim. ARC është duke marrë masa për përditësimin e regjistrimit civil dhe heqjen e të dhënave të personave të vdekur. Për të larguar nxitësit që kontribuojnë në mos-raportimin e rasteve të vdekjes, ARC ka nënshkruar një marrëveshje me spitalet dhe Bashkësinë Islame të Kosovës, e cila deri më tani ka pasur efekt të kufizuar. Sipas kësaj marrëveshjeje, spitalet dhe xhamitë duhet t'i raportojnë rastet e vdekjes në Zyrat Komunale të Gjendjes Civile (ZKGJC) dhe përfitimet sociale pezullohen automatikisht, me një procedurë të quajtur "regjistrim pasiv". Megjithatë, një person nuk mund të hiqet nga lista e votuesve derisa të lëshohet certifikata e vdekjes dhe kjo mund të bëhet vetëm me kërkesën e familjes.

Në nivelin lokal, ZKGJC-ja raporton shkallë të ndryshme të zbatimit të marrëveshjes qendrore të nënshkruar për raportimin e rasteve të vdekjeve. Vëzhguesit e EU EOM vizituan 30 nga 38 ZKGJC-të dhe vetëm 10 ishin duke bashkëpunuar rregullisht me spitalet lokale ose xhamitë për mbledhjen e raporteve të vdekjes. Me qëllim të inkurajimit të kërkesave për certifikata të vdekjes, komunat e Gjakovës, Prishtinës dhe Podujevës ofrojnë mbështetje financiare për shpenzimet e varrimit për familjet që regjistrojnë vdekjen brenda afatit ligjor prej 30 ditësh. Një skemë e ngjashme është duke u shqyrtuar edhe nga komuna e Klinës.

Për çdo zgjedhje KQZ përpilon një listë të veçantë për Votim jashtë Kosovës (VjK) në bazë të kërkesave të votuesve me të drejtë vote që banojnë jashtë Kosovës. Aplikuesit që regjistrohen me sukses për votimin jashtë Kosovës hiqen nga lista e votuesve të komunës ku ata kanë adresën e tyre të banimit në Kosovë. Në fund të periudhës së aplikimit KQZ-ja pranoi 11,813 aplikacione për regjistrimin e votuesve për VjK dhe 10,476 prej tyre u regjistruan me sukses. Përveç atyre që kanë aplikuar me sukses për VjK, shumica e kosovarëve të moshës për votim që jetojnë jashtë vendit janë ligjërisht të përfshirë në listën e votuesve të rregullt. Disa nga bashkëbiseduesit e EOM shprehën shqetësim se të dhënat e këtyre votuesve që banojnë jashtë vendit mund të keqpërdoren në ditën e zgjedhjeve. Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka vlerësuar se numri i banorëve të Kosovës jashtë vendit është rreth 700,000.

Votuesit nuk caktohen gjithmonë në vendvotimin më të afërt me vendbanimin e tyre, siç thuhet për shkak të mangësive në sistemin e adresave të Kosovës dhe për faktin se votuesit zakonisht nuk kërkojnë letërnjoftim të ri kur lëvizin në një vend tjetër (votuesit caktohen në vendvotimet në bazë të

adresës në letërnjoftimet e tyre, e jo në bazë të vendbanimit të tyre). ASK-ja vlerëson se rreth 300,000 kosovarë jetojnë në një komunë tjetër nga ajo ku ata janë të regjistruar zyrtarisht. Vendvotimet pajisen me kopje të listës së të gjithë votuesve në nivel komunal dhe në këtë mënyrë kanë mundësi t'i drejtojnë votuesit në vendvotimin e saktë në ditën e zgjedhjeve, nëse ai vendvotim është në të njëjtën komunë.

REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

Procesi i propozimit dhe certifikimit të kandidatëve për zgjedhjet lokale ishte gjithëpërfshirës. Gjatë periudhës së certifikimit u certifikuan që të 91 subjektet politike që kishin aplikuar. Mes tyre ishin regjistruar 35 parti politike, një koalicion, 30 iniciativa qytetare dhe 25 kandidatë të pavarur. Kanë qenë 6,887 kandidatë të certifikuar që garuan për kuvendet komunale, prej të cilëve 2,400 ishin gra. Numri i përgjithshëm i kandidatëve për kryetarë të komunave ishte 204, vetëm tetë prej të cilëve ishin gra.

Për herë të parë që prej hyrjes në fuqi të LZP-së në vitin 2008, KQZ-ja ka kërkuar shënime penale të të gjithë kandidatëve që kanë aplikuar, siç kërkohet me ligj. Meqenëse Kosova nuk ka një bazë të integruar të të dhënave gjyqësore, KQZ-ja u desh të kontaktojë të gjitha gjykatat themelore në Kosovë për të marrë këto informacione. 87 kandidatë të certifikuar u de-certifikuan nga KQZ-ja për shkak të dënimeve të tyre penale në tri viteve të fundit. 17 prej këtyre kandidatëve të de-certifikuar paraqitën ankesat me PZAP, të cilat u refuzuan si të pabazuara. Tre nga këta aplikues, përfshirë një anëtar të Kuvendit, u ankuan kundër vendimit të PZAP-së në Gjykatën Supreme, e cila ndryshoi përfundimisht ato dhe urdhëroi KQZ-në që të ri-certifikojë tre kandidatët.

Gjykata Supreme argumentoi se neni 29.1 të LZP-së ishte jokushtetues.³⁸ Kjo çështje ende nuk është referuar në Gjykatën Kushtetuese. Kjo krijon një situatë të vështirë për autoritetet, të cilat ligjërisht do të jenë të detyruara të aplikojnë nenin 29.1 të LZP-së, përveç në rastet specifike ku Gjykata Supreme ka urdhëruar ndryshe për ankues të caktuar. Megjithatë, KQZ-ja vendosi në mënyrë të papritur të aplikojë vendimin e Gjykatës Supreme për të gjithë 87 kandidatët të cilët ishin de-certifikuar për shkak të dënimeve penale. Vetëm 27 nga 87 kandidatët e ri-certifikuar dhanë dorëheqje ose u zëvendësuan nga subjektet e tyre politike. Prej 17 kandidatëve të njohur me emër për EOM, që ishin prekur nga ky ri-certifikim përkundër të dhënave të fundit penale, 14 garuan në zgjedhje dhe tre u zgjodhën në kuvendet komunale. Edhe pse është në mandatin e Gjykatës Kushtetuese të deklarojë një ligj si jokushtetues,³⁹ si duket askush nuk dëshiron ta dërgoj çështjen atje. Kryetarja e KQZ-së e ka pranuar se neni 29.1 i LZP-së lidhur me përshtatshmërinë e kandidatit nuk mund të zbatohet më përveç dhe derisa të mos ndodhë një reformë zgjedhore. Megjithatë, argumenti i Gjykatës Supreme do të aplikohet për tërë nenin 29.1 të LZP-së përveç shkronjës p, duke i bërë të pavlefshme të gjitha kriteret përveç njërit për përshtatshmërinë e kandidatit. Do të ketë nevojë për sqarime, qoftë gjatë reformës të shumëpritur zgjedhore, qoftë përmes vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

³⁸ Vendimi i Gjykatës Supreme mbështetet kryesisht në nenin 45 të Kushtetutës, ku thuhet se çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe në ditën e zgjedhjeve, e gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor. Megjithatë, vendimi nuk e merr parasysh nenin 55.1 të Kushtetutës i cili thekson se të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen (vetëm) me ligj.

³⁹ Sipas nenit 113.2 të Kushtetutës, Kuvendi, Presidenti, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të parashtrajnë çështje në lidhje me përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën në Gjykatën Kushtetuese.

Votimi jashtë Kosovës

Programi i votimit jashtë Kosovës (VjK) bazohet në votimin përmes postës dhe si i tillë është kritikuar në zgjedhjet e mëparshme se i mungojnë shumë masa mbrojtëse ndaj abuzimeve të mundshme. Në fillim të periudhës pesë javore të aplikimit, KQZ dërgoi formularët e aplikimit direkt tek 15,118 votuesit që ishin regjistruar si votues për VjK në zgjedhjet parlamentare të qershorit. KQZ-ja i pranoi 11,813 kërkesa dhe i miratoi 10,476 prej tyre. Procesi i votimit jashtë Kosovës me postë për raundin e parë të zgjedhjeve lokale filloi më 22 shtator ku afati i pranimit të fletëvotimeve me postë për VjK skadonte më 20 tetor 2017 në mesnatë. Numri i përgjithshëm i fletëvotimeve të pranuar me postë ishte 7.621, nga të cilat 6.735 janë aprovuar dhe 886 janë refuzuar.⁴⁰ Numri më i madh i fletëvotimeve të miratuara me postë kishin ardhur nga Serbia (2,006), Zvicra (1,335) dhe Gjermania (847) dhe komunat me numrin më të lartë të votave me postë ishin Istogu (1,413), Klina (434) dhe Graçanica (414).

EU EOM u njoftua për 33 votues nga Kllokoti dhe një votues nga Lipjani që parashtruan ankesa në PZAP duke pretenduar se dikush në mënyrë mashtruese kishte aplikuar në emër të tyre për t'u regjistruar si votues për VjK, kështu që ata u hoqën nga lista përfundimtare e votuesve. Këto ankesa u refuzuan pasi që ishin parashtruar pas afatit. Kreu i VSD-së pranoi se nuk kishte bazë ligjore për të anuluar asnjë prej këtyre regjistrimeve për VjK për komunën e Kllokotit dhe se nuk kishte mundësi që këta votues të riktheheshin në listën përfundimtare të votuesve. Nuk ka masa të mjaftueshme mbrojtëse kundër përvetësimit të identitetit të votuesve në procesin e Votimit jashtë Kosovës dhe ka mungesë të mjeteve juridike efektive për të trajtuar rastet e heqjes së të drejtës për të votuar që mësuan për largimin e tyre nga lista përfundimtare e votuesve vetëm pas skadimit të afatit për ankesa.

Për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetar komune, periudha e aplikimit për VjK zgjati 14 ditë nga data 4 nëntor deri më 17 nëntor. KQZ-ja ishte në gjendje të respektojë afatet për votimin VjK për 16 nga 19 komunat të cilat u përballen me balotazh, ndërsa në Istog, Obiliq dhe Kamenicë kishte një vonesë tre-ditore për shkak të ankesave të pazgjithura. Për të lehtësuar votimin VjK, KQZ-ja postoi fletëvotimet për balotazh në faqen e tyre të internetit dhe informoi votuesit për VjK që të shkarkojnë fletëvotimin përkatës dhe t'i dërgojnë ato me postë në një kuti postare të regjistruar më së voni deri më 17 nëntor. Për zgjedhjet e balotazhit në 19 komuna, KQZ-ja mori gjithsej 2,330 fletëvotime me postë dhe në mesin e tyre numri më i lartë 1,356 ishte përsëri nga komuna e Istogut.

Gjatë raundit të parë në Istog, gjithsej 1,366 fletëvotime me postë u ishin dhënë tre kandidatëve serbë për zgjedhjet e kuvendeve komunale, ndërsa për raundin e parë të zgjedhjeve për kryetar kishte vetëm 830 fletëvotime me postë, 795 prej të cilave ishin për kandidatin e LDK-së. Në raundin e dytë, megjithatë, ishin numëruar 1.337 fletëvotime të VjK-së për kandidatin e AAK-së dhe vetëm 18 vota VjK për kandidatin e LDK-së, i cili ishte duke kryesuar pas numërimit të të gjitha votave të rregullta brenda vendvotimeve. Votat e VjK-së patën një ndikim të papritur vendimtar mbi rezultatet e përgjithshme të raundit të dytë të zgjedhjeve për kryetar të komunës në Istog, ku pas numërimit të të gjitha votave me postë kandidati i AAK doli i pari me 671 vota. Pas një hetimi të ankesave rreth mashtrimit me vota të VjK-së në Istog, PZAP-ja urdhëroi të përsëritet votimi i raundit të dytë të zgjedhjeve për kryetar komune në këtë komunë. KQZ-ja vendosi të organizojë rivotimin në Istog më 17 dhjetor 2017, me një periudhë pesëditore të verifikimit të identitetit, e cila përfshinte informatat e kontaktit dhe vendbanimin e votuesve për VjK për të konfirmuar regjistrimin e tyre për VjK. Vetëm

⁴⁰ Arsyet kryesore për refuzim ishin kryesisht votuesit për VjK që dërguan zarfet postare më shumë se një herë (329), personat që nuk kishin dërguar ndonjë dokument identifikimi (305) dhe personat që nuk kishin aplikuar për votimin VjK (158).

85 nga 1,587 votues VjK e konfirmuan statusin e tyre si votues për VjK, ndërsa 1,467 votues tjerë u rikthyen përsëri në listën përfundimtare të votuesve në komunën e Istogut.

Raundi i parë i zgjedhjeve për kryetarë të komunave dhe kuvende komunale, 22 Tetor 2017

Dita e zgjedhjeve ishte e qetë, pa incidente të mëdha të regjistruara nga vëzhguesit e EU EOM, të cilët vizituan 466 vendvotime në të 38 komunat. Vendvotimet në përgjithësi u hapën në kohë dhe u përgatitën për votim. Sidoqoftë, në komunën e Deçanit, disa KVV-ve iu desh të pezullonin procesin e votimit për një orë herët në mëngjes për shkak të shpërndarjes së vulave të gabuara të KVV-ve. Çështja u zgjidh nga autoritetet zgjedhore pa ndikuar në vlefshmërinë e votave të hedhura. Procedurat e hapjes kryesisht u respektuan, dhe hapja u vlerësua pozitivisht në të gjitha vendvotimet e vëzhguara.

Në përgjithësi, procesi i votimit u vlerësua si i mirë ose shumë i mirë në mbi 99 për qind të vendvotimeve. Përgjithësisht u zbatuan procedurat e votimit. Vëzhguesit e EU EOM vërejtën shumë raste të votimit familjar (në dhjetë për qind të vëzhgimeve). Disa votues u kthyen prapa në 11 për qind të vendvotimeve të vëzhguara, kryesisht për shkak se nuk ishin në listën e votuesve, me gjasë ata u paraqitën në vendvotimin e gabuar. Sipas të dhënave të regjistruara në librat e anketës, në 21 për qind të vendvotimeve të vëzhguara përqindja e ndihmës në votim ishte mbi dhjetë për qind.

Vëzhguesit e EU EOM vunë në dukje se 44 për qind e vendvotimeve të vizituara nuk kishin qasje për votuesit me aftësi të kufizuara.

KQZ-ja nuk e ka qartësuar mjaft çështjen e dokumenteve të pranueshme. Në shumicën e vendvotimeve, dokumentet serbe të identifikimit u pranuan për votim të rregullt, me një numër të vogël përjashtimesh. Për votimin me kusht, nuk kishte interpretim të njëjtë të rregullave nga stafi i KVV-së nëpër vendvotime të ndryshme.

Performanca e stafit në vendvotime u përkeqësua në fazën e numërimit, ku vetëm 80 për qind të numërimeve të vëzhguara u vlerësuan si pozitive. Edhe pse KQZ-ja kishte thjeshtësuar formularët, në përputhje me rekomandimin e përkohshëm të bëra nga EU EOM i vendosur për zgjedhjet e parakohshme të qershorit, stafi i vendvotimit në një të tretën e vendvotimeve të vëzhguar pati vështirësi që të plotësonte në mënyrë korrekte Formularët e Rezultateve të Kandidatëve. Vështirësi në plotësimin e Formularit të Përputhjes së Rezultateve janë vërejtur në 37 për qind të numërimeve të votave të vëzhguara. Formularët e rezultateve të vendvotimeve ishin postuar publikisht në 88 për qind të numërimeve të vëzhguara të votave, duke lejuar vëzhguesit nga subjektet politike të kopjonin rezultatet nga vendvotimet.

Vëzhguesit e EU EOM vizituan 30 qendra grumbulluese të KKZ-ve dhe procesi u vlerësua si pozitiv në të gjitha ato. Korrigjimi i materialeve dhe dokumenteve të vendvotimeve ishte i nevojshëm të paktën një herë në 40 për qind të KKZ-ve të vëzhguara, duke treguar se nevojitet trajnim shtesë për stafin e vendvotimeve.

Dy kanale kryesore televizive private, *Klan Kosova* dhe *TV Dukagjini*, shkelën periudhën e heshtjes së fushatës duke mbuluar konferencat për shtyp të partive politike gjatë ditës së zgjedhjeve.

Votimi ose Procesi i votimit në katër komunat veriore

Me kërkesë të KQZ-së, Misioni i OSBE-së në Kosovë ofroi mbështetje teknike dhe ndihmë për katër KKZ-të dhe 86 KVV-të në komunat e Mitrovicës (Veri), Zubin Potokut, Zveçanit dhe Leposaviqit. Në ditën e zgjedhjeve, ekipet e OSBE-së ishin të pranishme në çdo vendvotim në katër komunat veriore prej hapjes deri në përfundim të numërimit, me autorizime për të raportuar shkeljet dhe

njoftuar zyrtarët e zgjedhjeve për parregullsitë. Personeli i OSBE-së shoqëroi transportin e materialeve zgjedhore nga vendvotimet në qendrat e grumbullimit të KKZ-së në veri dhe më pas në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve.

Raundi i dytë i zgjedhjeve për kryetarë të komunave, 19 nëntor 2017

Me 19 nëntor, EOM vizitoi 292 vendvotime të ndryshme. Hapja dhe votimi ishin të qeta dhe të rregullta dhe numërimi kryesisht u zhvillua në mënyrë transparente dhe efikase. Megjithatë, disa aspekte të rëndësishme të procesit zgjedhor lënë hapësirë për përmirësim.

Qasja në objektet e vendvotimeve për persona me aftësi të kufizuara ishte e vështirë në 44 për qind të vendvotimeve të vizituara. Aranzhimi i vendvotimeve nuk ishte i përshtatshëm për personat me aftësi të kufizuara të lëvizjes në më shumë se një të pestën e vendvotimeve të vëzhguara.

Misioni vëzhgoi hapjen në 24 vendvotimeve, të cilat në përgjithësi u hapën me kohë. Në disa raste ishte vërejtur se stafi i vendvotimeve dhe vëzhguesit e subjekteve politike erdhën me vonesë, çka shkaktoi vonesa të vogla. Hapja u vlerësua pozitivisht në të gjitha vendvotimet e vëzhguara.

Votimi u zhvillua në mënyrë të qetë dhe, në përgjithësi, procesi i votimit u vlerësua pozitivisht në të gjitha vendvotimet, ku stafi zgjedhor kryente punën mirë dhe zhvillonte operacionet në mënyrë transparente, me përjashtim të dy vendvotimeve të vizituara. Gratë kishin përfaqësim të ulët në këshillat e vendvotimeve, duke përbërë 26 për qind të stafit zgjedhor në vendvotimet e vëzhguara. Në 14 për qind të vendvotimeve të vizituara, kryesuese e këshillit ishte një grua.

Të kuptuarit e procedurave të votimit nga votuesit vazhdon të jetë një fushë ku duhet të bëhen përmirësime. Votimi i asistuar u përdor shpesh dhe jo gjithmonë nga votuesit që nuk ishin në gjendje të votonin vet. Më shumë se 10 për qind e votimit të asistuar ishte regjistruar në regjistrat e votimit në 43 vendvotime. Fshtësia e votës është ndikuar negativisht nga praktika siç është votimi familjar dhe grupor, që ishte vërejtur në 15 vendvotime.

Materiale të fushatës janë vërejtur afër 18 vendvotimeve të vizituara. EOM ka marrë disa raporte të grumbullimit të aktivistëve jashtë qendrave të votimit por prania e policisë parandaloi eskalimin e situatës.

Vëzhguesit vendorë ishin të pranishëm në mbi 90 për qind të vendvotimeve të vizituara dhe të dy kandidatët përkatës ishin të përfaqësuar me vëzhgues në më shumë se 85 për qind të vendvotimeve të vëzhguara.

Numërimi u vëzhgua në 29 vendvotime dhe në 25 prej tyre ai është vlerësuar pozitivisht. Stafi i zgjedhjeve i kreu detyrat e veta në mënyrë transparente dhe, me disa përjashtime të rëndësishme, ishin kompetent. Në tri vendvotime të vizituara ishin vërejtur vështirësi në plotësimin e FPR. Në dy nga vendvotimet e vizituara procedurat e mbylljes nuk ishin ndjekur si duhet dhe në një vendvotim tjetër përputhja e fletëvotimeve ishte problematike. Në dy vendvotime të tjera nuk ishin postuar formularët e rezultateve. Numërimi në një vendvotim në Partesh ishte veçanërisht problematik, ku vëzhguesit e subjekteve politike kishin ndërhyrë në proces dhe në mashtrimin e pretenduar.⁴¹

⁴¹ Në këtë vendvotim 203 vota ishin numëruar si të zbrazëta, dhe nuk kishin shenjë me ngjyrë, por që paraqisnin gjurmët që tregojnë përdorimin e mundshëm të një stilolapsi që i ka humbur ngjyra.

EU EOM vëzhgoi dorëzimin e materialeve në 20 objekte të Komisioneve Komunale Zgjedhore (KKZ). Përkundër disa problemeve të vogla, të gjitha ishin vlerësuar pozitivisht. Lokalet ishin joadekuate në tri KKZ dhe pothuaj gjysma e tyre ishin të mbingarkuara, megjithatë puna e KKZ-ve ishte bërë në mënyrë profesionale. Në një të tretën e KKZ-ve të vizituara stafi i zgjedhjeve u desh të bënte korrigjime të vogla para se të dorëzonte materialet. Për pjesën më të madhe, korrigjimet kishin të bënin me plotësimin e formularëve të rezultateve dhe paketimin e materialeve.

Me 19 nëntor, dhoma e kontrollit e Kryeprokurorit raportoi për 23 incidente të hetuara, prej të cilëve vetëm një ishte dërguar në procedurë penale. Me 20 nëntor, PZAP mori 10 ankesa lidhur me votimin dhe numërimin.

Tabelimi dhe Shpallja e Rezultateve

KQZ-ja në faqen e saj të internetit publikoi të dhëna rreth daljes së votuesve dhe rezultatet e hershme preliminare të zgjedhjeve për kryetarë të komunave dhe rezultatet e subjekteve politike në zgjedhjet për kuvende komunal. Operatorët e të dhënave të shpërndarë në të gjitha vendvotimet regjistruan rezultatet nga vendvotimet në bazën e të dhënave K-Vote, përveç votave preferenciale për kandidatët. Për shkak të problemeve teknike, faqja e internetit e KQZ-së nuk ishte e qasshme kohën më të madhe në natën e zgjedhjeve, megjithatë ajo paraqiti një ndarje të rezultateve të hershme preliminare sipas vendvotimeve. Kjo iu dha subjekteve politike mundësinë që të krahasojnë rezultatet e postuara apo të kopjuara nga vëzhguesit e tyre në vendvotime.⁴²

Tabelimi i rezultateve zyrtare si për zgjedhjet për kryetarë të komunave ashtu dhe për kuvende komunale u zhvilluan në QNR. QNR-ja gjendet në një depo afër Prishtinës ku grumbullohet materiali i zgjedhjeve nga të gjitha komunat, shqyrtohet, përpunohet dhe arkivohet. Votat me kusht, votimi i personave me nevoja të veçanta, VjK dhe çdo fletëvotim i rregullt kur kërkohet nga KQZ-ja ose PZAP-ja numërohen në QNR. Formularët e rezultateve nga çdo vendvotim regjistrohen, kontrollohen, tabelohen dhe rezultatet përfundimtare përpilohen në QNR.

Më 23 tetor gjatë fazës së pranimit, materiali zgjedhor nga e gjithë Kosova u dorëzua në QNR. Nga gjithsej 5,010 kuti votimi, 135 u dërguan në karantinë për shkak të numrave të gabuar të vulave, ose formularëve të paplotësuar ose mungesës së nënshkrimeve. Nga 135 kutitë e votimit, pesë kuti për zgjedhjet për kryetarë të komunave dhe 22 për zgjedhjet për kuvende komunale duhej të rinumëroheshin pasi që atyre u mungonin materialet të ndjeshme ose paraqitën formularë të paplotësuar të rezultateve, të zbrazëta ose të plotësuar gabimisht.

Pas fazës së pranimit, QNR i skanoi formularët e rezultateve nga vendvotimet dhe i futi ato në sistem. Kontrolli dhe hetimi i formularëve të rezultateve të zgjedhjeve për kryetarë të komunave dhe për kuvende komunale dhe i formularëve të rezultateve të kandidatëve ishin pjesë e rëndësishme e procedurave të QNR-së, pasi ato zbulojnë mospërputhje midis votave preferenciale të kandidatëve të regjistruar dhe rezultateve për subjektet politike.

Pas auditimit të rezultateve, KQZ-ja vendosi të bëjë rinumërimin e plotë të tetë kutive të votimit për kryetarë të komunave dhe 695 kutive të votimit për kuvende komunale që nuk mund të kalonin kontrollin për shkak të mospërputhjeve në formularët e rezultateve për numrin e votave për subjektet politike dhe të votave preferenciale për kandidatët. Procesi i rinumërimit të 695 kutive të votimit për

⁴² Pas raundit të dytë, QNR u desh të korrigjoj rezultatet e hershme për kandidatët për kryetar të komunës në Prishtinë pas njoftimit të LDK-së për gabimet e të dhënave në dy vendvotime, duke e zvogëluar diferencën e votave nga 307 në 237.

kuvendet komunale u zhvillua në prani të vëzhguesve të subjekteve politike, dhe u vlerësua nga vëzhguesit e EU EOM si kryesisht transparent. Për të rritur transparencën, KQZ-ja vendosi të postojë në faqen e saj të internetit të gjithë formularët e rezultateve nga numërimet fillestare nga KVV-të në qendrat e votimit dhe formularët e rezultateve të reja pas rinumërimeve.⁴³

Sipas analizës së EU EOM që krahasonte protokollet para dhe pas 257 rinumërimeve të përzgjedhura, 55 për qind e tyre treguan mospërputhje të vogla deri në një dallim prej pesë votash për subjektet politike. Një e treta e protokolleve nuk treguan asnjë mospërputhje në votat për subjektet, por vetëm për preferencat e kandidatëve. Në mënyrë domethënëse, pesë për qind e formularëve të analizuar treguan mospërputhje prej pesë deri në dhjetë vota për një subjekt politik dhe një mospërputhje tjetër prej pesë për qind për një subjekt politik që sillej nga 11 deri në 123 vota.⁴⁴

Nuk ka afat ligjor për certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve nga KQZ-ja, sepse kjo duhet të bëhet pas përfundimit të të gjitha procedurave të QNR-së dhe pas gjykimit të parashtresave dhe ankesave që mund të çojnë në rinumërime të mundshme ose në rivotim. Pasi që raundi i dytë i zgjedhjeve për kryetar kërkohet ligjërisht që të mbahen katër javë pas raundit të parë, KQZ-ja e ka ngarkuar QNR-në t'i japë përparësi tabelimit dhe përpilimit të rezultateve të raundit të parë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave. Prandaj, numërimi i fletëvotimeve me kusht fillimisht u bë vetëm pjesërisht, duke i dhënë përparësi zgjedhjeve për kryetarë të komunave, ndërsa fletëvotimet me kusht për kuvendet komunale u numëruan vetëm pas kryerjes së të gjitha rinumërimeve. Nga 15,540 votues të cilët votuan me kusht, 4,856 fletëvotime u refuzuan pasi kryesisht këta votues i shënjuan fletëvotimet e tyre për komunën në të cilën ata nuk gjendeshin në listën e votuesve ose nuk gjendeshin fare në listën e votuesve.

KQZ-ja publikoi më 31 tetor rezultatet e raundit të parë për kryetarë të komunave për 38 komuna, duke shënuar gjithashtu fillimin e një periudhe 24-orëshe për ankesa. Më 3 nëntor, KQZ-ja certifikoi zyrtarisht rezultatet e raundit të parë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave në 32 komuna dhe më 6 nëntor në pesë komunat ku u refuzuan ankesat, ndërsa në Komunën e Parteshit PZAP-ja urdhëroi rivotim. Dalja e votuesve në zgjedhjet për kryetar komune në raundin e parë arriti në 44.1 për qind dhe numri i përgjithshëm i fletëvotimeve të pavlefshme ishte 13.814 (1.6 për qind) dhe kishte 7.989 (0.95 për qind) fletëvotime të zbrazëta.

KQZ i shpalli rezultatet e zgjedhjeve për kuvende komunale për të gjitha 38 komunat me 9 nëntor. Të dhënat e detajuara përfshinin një ndarje të rezultateve sipas komunave dhe vendvotimeve, përfshirë edhe votat preferenciale për kandidatët individualë dhe ulëset në kuvendet komunale sipas partive politike. Ndryshe nga rezultatet për kryetar komune, KQZ-ja nuk publikoi rezultatet e përmbledhura përfshirë numrin e përgjithshëm të fletëvotimeve të pavlefshme. Sipas analizës së EU EOM, përqindja e fletëvotimeve të pavlefshme dhe të zbrazëta për zgjedhjet për kuvende komunale mbeti shumë e lartë, duke arritur në 8.7 për qind.⁴⁵ Krahasuar me nivelin e vitit 2013 prej dhjetë për qind të votave të pavlefshme, kjo praqet vetëm një përmirësim të vogël. Arsyet kryesore mund t'i atribuohen të kuptuarit të dobët të votuesve të kompleksitetit të votimit për kuvende komunale me dy vota dhe mungesës së përgjithshme të edukimit të votuesve.

Më 14 nëntor KQZ-ja duhej të zbatonte vendimin e PZAP-së për rinumërimin e fletëvotimeve në 435 kuti për kuvende komunale bazuar në ankesat e subjekteve politike. Çuditërisht, PZAP përfshiu në

⁴³ QNR-ja i ka postuar ato, megjithatë rezultatet origjinale nga komuna e Deçanit nuk ishin në dispozicion në internet.

⁴⁴ Shumica e rasteve me mospërputhje në rezultate janë vërejtur në Gjakovë, Rahovec, Pejë dhe Prizren.

⁴⁵

vendimet e saj edhe 71 kuti të cilat tashmë ishin rinumëruar në QNR pa ndonjë shpjegim se pse ato duhej të rinumëroheshin prapë. EU EOM i analizoi dhe krahasoi 159 formularë të 435 rinumërimeve dhe gjeti se 54 për qind treguan mospërputhje të vogla deri në pesë vota për një subjekt politik, ndërsa 43 për qind nuk treguan mospërputhje në vota për subjektet politike, por vetëm në vota preferenciale për kandidatët. Një mospërputhje prej gjashtë deri dhjetë vota u shënuar vetëm në 2.5 për qind të mostrës dhe nuk kishte asnjë rast të mospërputhjes për më shumë se dhjetë vota për një subjekt politik.

KQZ-ja certifikoi më 29 nëntor rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve për kuvende komunale për 37 komuna, me përjashtim të Vushtrrisë për shkak të ankesave që nuk ishin zgjidhur akoma. 435 rinumërime të urdhëruara nga PZAP-ja nuk sollën ndonjë ndryshim të rëndësishëm në votat për subjektet politike, megjithatë pati ndryshime në votat preferenciale pasi 14 kandidatë për 11 kuvende komunale u certifikuan si të zgjedhur duke zëvendësuar 14 kandidatë të zgjedhur të publikuar më parë nga KQZ-ja.

Pranimi i materialeve zgjedhore nga njëzet komuna ku votimi u zhvillua më 19 nëntor ishte më i qetë se në raundin e parë. Pas pranimit, 30 kutitë e votimit u vendosën në karantinë për shkak të materialeve jo të plota ose mungesës së nënshkrimeve. KQZ-ja vendosi të rinumërojë një kuti votimi nga Prizreni për shkak të një gabimi të gjetur në formularin e rezultateve dhe 22 fletëvotime me kusht u shfuqizuan për shkak të mungesës së nënshkrimeve në listën e votuesve me kusht.

Pas regjistrimit të të gjithë formularëve të rezultateve, QNR-ja fillimisht hetoi katër kuti të votimit që nuk e kaluan kontrollin, por më vonë i procesuan ato si të rregullta. EU EOM vuri në dukje se sistemi nuk ka të krijuar një kontroll të tërthortë për të gjitha mospërputhjet e mundshme të gjetura në formularët e rezultateve ose për të nxitur hetimin e të dhënave të papranueshme. Dy protokolle problematike nga numërimi i votave të vëzhguara nga EU EOM nuk ishin shënjuar nga sistemi dhe e kaluan kontrollin pa hetime, edhe pse në protokollin e KVV-së të Parteshit regjistruan 203 fletëvotime të zbrazëta nga 405 fletëvotimeve të gjetura në kutinë e votimit.

Pas regjistrimit të të gjitha të dhënave në sistem, përfshirë të gjithë votuesit e rregullt që kanë nënshkruar listat e votuesve, të dhënave të votuesve nga zarfet e votimit me kusht u futën në sistem për të kontrolluar të drejtën e tyre për të votuar në komunën përkatëse dhe për të verifikuar nëse ndonjëri prej tyre tashmë është i regjistruar se ka votuar. QNR-ja hodhi poshtë 131 fletëvotime nga 545 votues të regjistruar me nevoja të veçanta nga burgu i Dubravës në Istog për shkak të kodeve të gabuara në zarf ose për shkak të mungesës së emrave në listën e votuesve, megjithatë, pati më pak raste të refuzimit të fletëvotimeve të të burgosurve në krahasim me raundin e parë.

Plani i KQZ-së për të numëruar 7,649 fletëvotime me kusht, 1,175 fletëvotime të personave me nevoja të veçanta dhe 2,330 fletëvotime me postë për VJK ndryshoi me 23 nëntor për shkak të vendimit të papritur të PZAP-it që urdhëroi rinumërimin e votave të të gjitha kutive të votimit në Prishtinë dhe Prizren, 35 kutive të votimit në Dragash dhe tri kutive të votimit në Rahovec. KQZ-ja diskutoi se si të vazhdojë me numërimin e votave me kusht, votave të personave me nevoja të veçanta dhe fletëvotimeve me postë dhe kur të fillojë rinumërimin e urdhëruar nga PZAP-ja në pritje të vendimit nga Gjykata Supreme lidhur me ankesat përkatëse. Më 23 nëntor QNR-ja rinumëroi votat me kusht, VPNV dhe VJK për 16 nga 20 komuna dhe pezulloi procesin e numërimit në pritje të vendimit të Gjykatës Supreme.

Më 26 nëntor QNR-ja rinumëroi votat e balotazhit nga 35 vendvotime në Dragash dhe tri vendvotime në Rahovec pa ndikim në rezultate. QNR-ja numëroi votat me kusht, VPNV dhe VJK për komunat e Prishtinës dhe Prizrenit me aplikimin e masave shtesë të transparencës duke lejuar praninë e një numri

më të madh të vëzhguesve nga subjektet politike dhe duke mundësuar qasjen e mediave në transmetim të drejtpërdrejtë të numërimit të votave nga dy komunat më të mëdha.

Më 26 nëntor, një ekip i PZAP-së hetoi votat me postë të VjK-së nga Istogu dhe Kllokoti si pjesë e gjykimit të ankesave lidhur me këto vota me postë. Kishte deklarata publike, pohime dhe ankesa se në këto dy komuna manipuloheshin votat me postë të VjK-së në atë mënyrë që kishin një ndikim vendimtar në rezultatet e zgjedhjeve për kryetarë të komunave. Në Istog, kandidati i AAK-së mori 1.337 nga gjithsej 1.355 vota të VjK-së dhe kështu kaloi në epërsi ndaj kandidatit të LDK-së, i cili fillimisht ishte në krye me 648 vota pas numërimit të votave të rregullta dhe atyre me kusht. Si rezultat i vendimit të PZAP-së për të përsëritur votimin për balotazh për kryetar komune në komunën e Istogut, KQZ-ja vendosi që rivotimi të bëhet me 17 dhjetor dhe duhej verifikuar regjistrimi i votuesve për VjK. Në Kllokot kandidati i Listës Serbe që fillimisht printe humbi për një diferencë prej dhjetë votash për shkak të 19 votave të VjK-së⁴⁶, të cilat iu dhanë kandidatit kundërshtar të IQ Klokot-Vrbovc. KQZ shpalli rezultatet e raundit të dytë për kryetarë të komunave më 29 nëntor, me përjashtim të Istogut dhe Kllokotit për shkak të ankesave të parashtruara në PZAP dhe në Gjykatën Supreme.

Në përgjithësi, QNR-ja luan një rol të rëndësishëm në sigurimin e një niveli të nevojshëm shtesë të kontrollit gjatë procesit zgjedhor dhe mbetet e domosdoshme për të siguruar të dhëna të sakta nga vendvotimet. Edhe pse niveli i transparencës në këtë fazë është rritur dukshëm, ende ka nevojë për shumë përmirësime lidhur me saktësinë, efikasitetin dhe kontrollin e cilësisë.

ZGJIDHJA E KONTESTEVE ZGJEDHORE

Parashtresat dhe Ankesat

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) është një institucion i pavarur përgjegjës për gjykimin e ankesave lidhur me zgjedhjet, përpos kontestimeve të listës së votuesve dhe ankesave lidhur me mediat. PZAP-ja përbëhet nga 10 gjyqtarë, dy nga të cilët janë femra, përfshirë Kryesuesin, që emërohet nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme. Paneli mbështetet nga një sekretariat i përhershëm, por i mungon mjedisi adekuat për të përmbushur plotësisht përgjegjësitë e tij. Kjo çështje është shoqëruar me një numër të madh të ankesave nga zgjedhjet e kaluara dhe afatet e ngushta për paraqitjen dhe vendimet.

Struktura e përhershme e PZAP-së është funksionale me numrin aktual të gjyqtarëve dhe punonjësve. Gjatë zgjedhjeve forcohet kapaciteti i sekretariatit. Për arsye të mungesës së burimeve, zyra për punë, kohës dhe fuqisë punëtore, PZAP-ja zakonisht nuk zhvillon seanca dëgjimore. Përkundër sfidave që dalin nga një numër shpesh i madh i ankesave dhe mungesës së burimeve adekuate, PZAP-ja ka bërë përparim duke zbatuar pjesërisht rekomandimet e sugjeruara nga EU EOM-të e mëparshme, të cilat nuk kërkonin ndryshime legjislativë. Këto përfshijnë trajnimin e stafit të sekretariatit, mbajtjen e disa dëgjimeve aty ku paraqiten prova të mjaftueshme, dhe publikimin e vendimeve në internet. Që nga fundi i 2016, PZAP-ja gjithashtu e operon edhe një bazë të re të të dhënave publike për përcjelljen e parashtresave dhe ankesave.

⁴⁶ Në Kllokot votat e VjK-së ishin shumë kundërhënësë që në raundin e parë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave, ku të gjitha 32 votat e VjK i ishin dhënë kandidatit të Listës Serbe.

Ankues mund të jetë çdo person, fizik ose juridik, me interes ligjor në çështje, ose të drejtat e të cilit lidhur me procesin zgjedhor janë shkelur. Këta janë votuesit, subjektet politike, anëtarët e KVV-së ose të KKZ-së, ose vëzhguesit e partive politike. PZAP pranon edhe ankesat e paraqitura nga OJQ-të. Ankuesit i kanë 24 orë kohë pas mbylljes së vendvotimeve për të parashtruar ankesa lidhur me procesin e votimit dhe 24 orë nga shkelja e supozuar për ankesat që kanë të bëjnë me periudhën e heshtjes dhe numërimin dhe tabelimin. Sidoqoftë, PZAP i ka 72 orë nga pranimi i ankesës për të sjell vendimin, kundër të cilit mund të bëhet ankesë në Gjykatën Supreme brenda 24 orësh, nëse gjoba është më e madhe se 5,000 EUR ose kur ka të bëjë me një të drejtë themelore.

PZAP-ja ka trajtuar ankesat sipas ligjit, i cili nuk ofron shumë udhëzime dhe duke ndjekur rregulloret e saj të brendshme, me përjashtim të rëndësishëm të "mos lejimit" të ankesave pas votimit dhe numërimit deri në publikimin e rezultateve përfundimtare. Këto ankesa duhet të lejohen sipas ligjit. Nga ana tjetër, paneli lejon ankesa dhe parashtrës, varësisht se si ata që i paraqesin ato zgjedhin që t'i emërojnë ato, në rezultatet përfundimtare të publikuara nga KQZ-ja. Megjithatë, LZP parashikon ankesa vetëm për disa vendime të numëruara të KQZ-së, dhe nuk parasheh ankesë në lidhje me vendimet e KQZ-së. Kjo qasje synon të kursej panelin dhe të mos merret me të njëjtin vendvotim disa herë ose me raste të cilët në fund rezultojnë të jenë të parëndësishme për rezultatin e zgjedhjeve dhe gjithashtu u jep ankuesve më shumë kohë për të përgatitur një ankesë të duhur duke përfshirë edhe dëshmitë. Kjo është një qasje praktike drejt drejtësisë zgjedhore, duke marrë parasysh numrin e rasteve dhe afatet e shkurtra. Sidoqoftë, nuk ekziston bazë ligjore aktuale për këtë praktikë, e cila ndonjëherë çon në konfuzion lidhur me afatet e paraqitjes dhe mund të sjell vonesa në certifikimin e rezultateve.

Pas 22 tetorit, PZAP-ja pranoi 263 ankesa lidhur me ditën e zgjedhjeve, kryesisht lidhur me parregullsi në procesit të votimit (101 ankesa) ose parregullsi në procesin e numërimit (147 ankesa). Disa çështje më të vogla për ditën e zgjedhjeve kishin të bënin me shkeljen e periudhës së heshtjes, gjetjen e personave të vdekur në listën e votuesve, ose posterëve të fushatës në ambientet e vendvotimeve. Nga 263 ankesa lidhur me ditën e zgjedhjeve, vetëm tetë - lidhur me heshtjen zgjedhore - u miratuan nga PZAP. 51 u refuzuan si të paraqitura pas afatit, 27 si të parregullta (p.sh. u mungonin nënshkrimet) dhe 156 si të pa lejueshme, por me indikacionin se ato mund të dorëzoheshin përsëri nëse janë ende relevante pas publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja. Këto 263 ankesa kishin të bënin me zgjedhjet për kryetarë të komunave dhe me ato për kuvende komunale.

PZAP-ja përsëri hodhi poshtë të gjitha ankesat që kishin të bënin me votimin dhe numërimin, të cilat ishin parashtruar si duhet brenda 24 orëve nga mbyllja e vendvotimeve, si të palejueshme, duke iu treguar ankuesve mundësinë e paraqitjes së këtyre ankesave pas publikimit të rezultateve përfundimtare. Kjo çoi në një vonesë të procesit zgjedhor. Për raundin e parë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave, PZAP-ja në fillim refuzoi pjesërisht ankesën lidhur me marrje të ryshfetit në Partesh, kur u paraqit menjëherë pas zgjedhjeve më 22 tetor. Paneli e gjobiti Listën Serbe me 11,000 euro për kryerjen e "veprimeve të ndaluara", por hodhi poshtë kërkesën e ankuesit për të anuluar zgjedhjet, duke shtuar se ankuesi nuk ishte përjashtuar nga paraqitja e një ankese pasi KQZ-ja të publikoj rezultatin përfundimtar. Ajo ankesë më vonë u miratua. Kjo rezultoi në një vonesë prej nëntë ditësh për KQZ-në që të përsëris zgjedhjet për kryetar komune në Partesh.

Pak para zgjedhjeve, kandidati për kryetar i Listës Serbe (dhe pastaj kryetar i zgjedhur) në Partesh dyshohet se ishte pajtuar që të paguante secilin votues të mundshëm 30 deri në 50 euro për të votuar për të. Një regjistrim i një bisede telefonike mes dy burrave u paraqit si provë, ku kandidati gjithashtu premtoi të paguante bashkëpunëtorin e tij gjatë katër viteve të ardhshme. PZAP-ja e ka gjetur ankesën

nga kandidati për kryetar të komunës i Nismës Qytetare Narodna Sloga si të bazuar, duke anuluar rezultatet e zgjedhjeve për kryetar të komunës në tërë komunën e Parteshit dhe duke urdhëruar KQZ-në që të përsëris zgjedhjet për kryetar komune në të gjitha vendvotimet atje. Gjykata Supreme mbështeti këtë vendim të PZAP-së më 7 nëntor. Pavarësisht faktit se prokurori arrestoi dy persona të përfshirë në blerjen e votave dhe i paraburgosi ata në arrest shtëpiak (por jo kandidatin) dhe po e hetonte më tej çështjen, kandidati i Listës Serbe u zgjodh kryetar i komunës në balotazh.

Nga pesë ankesat e tjera lidhur me rezultatet e zgjedhjeve për kryetar komune, katër u refuzuan si të pabazuara. Këto kishin të bënin me parregullsi në procesin e numërimit (që u refuzuan për shkak se nuk ishin paraqitur dëshmi relevante). Një ankesë u hodh poshtë pasi ishte parashtruar pas afatit, pasi që kishte të bënte me një pretendim se një votues u gjet me një fletëvotim në përfundim të ditës së zgjedhjeve në Junik, duke treguar mundësinë e votimit karusel.

Pas publikimit të rezultateve përfundimtare për kuvendet komunal, PZAP mori 495 ankesa, të cilat duhej t'i zgjidhte brenda 72 orësh. Në këtë periudhë kohore, përveç procedurës së zakonshme, PZAP-ja hetoi 38 kuti të votimit në QNR, duke punuar me pesë ekipe hetimore. Paneli shfrytëzoi deri në 72 orë shtesë për të ofruar kopje të vendimeve të tij të shkruara, një dispozitë që ndonjëherë ai e zbatonte për tu marrë me numrin e madh të rasteve. Nga 495 ankesa, PZAP-ja miratoi 177 dhe refuzoi 268 si të pabazuara, një ankesë nuk u lejua, dy u refuzuan si të paraqitura pas afatit, dhe 47 si të parregullta. PZAP më tej urdhëroi KQZ-në të rinumëroi(rinumëroj) 440 kuti të votimit. Rreth 70 prej tyre ishin rinumëruar njëherë nga QNR për shkak të mosfunksionimit të kontrollit, duke treguar nevojën për komunikim më të mirë ndërmjet KQZ/QNR dhe PZAP-së.

Përndryshe, paneli ka ndjekur procedurat dhe ka respektuar afatet e tij të shkurtra në rrethana të vështira. Arsyetimi për vendimet e tij paraqitet, që shpesh janë shumë të pakta dhe nganjëherë paqëndrueshme, dhe vendimet publikohen në faqen e internetit të PZAP-së, megjithëse me disa vonesa. Paneli përgjithësisht perceptohet se vepron në mënyrë jo politike, por më pak i tillë pas vendimeve të raundit të dytë për të urdhëruar rinumërimin e tërësishëm në Prishtinë dhe Prizren.

Pas ditës së zgjedhjeve të 19 nëntorit, dhe pasi u kritikuan nga KQZ dhe EU EOM për refuzimin e ankesave të parashtruara menjëherë pas ditës së zgjedhjeve, PZAP-ja u mor në aspektin material me dhjetë ankesa të paraqitura më 20 nëntor. PZAP urdhëroi që të rinumërohen të gjitha vendvotimet në Prishtinë dhe Prizren, si dhe 35 vendvotime në Dragash dhe tri në Rahovec. Një vendim tjetër urdhëroi KQZ-në të regjistrojë për kandidatin e Vetëvendosjes votat e regjistruara gabimisht për një kandidat të PDK-së në Prizren.

Vendimet e PZAP-së për të rinumëruar kutitë e votimit nga të gjitha vendvotimet në komunat më të mëdha të Prishtinës dhe Prizrenit bazoheshin në dëshmi të pakta të siguruara, pa ndërmarrë ndonjë hetim shtesë dhe pjesërisht të arsyetuar në mënyrë të jokonsistente.⁴⁷ Këto nuk u pranuan nga kandidatët e Vetëvendosjes për kryetarë të komunave (të cilët parashtruan ankesë kundër vendimeve të PZAP-së në Gjykatën Supreme të premtën me 24 nëntor). Me 25 nëntor, Gjykata Supreme vendosi kundër të rinumërimit të plotë që ishte urdhëruar nga PZAP për të gjitha vendvotimet në Prishtinë dhe Prizren, duke i ndryshuar vendimet e PZAP-së për hedhjen poshtë të ankesave përkatëse të LDK-së dhe PDK-së në favor të VV-së.

Në rastin e Prishtinës, gjykata argumentoi se nuk kishte ndonjë dispozitë ligjore që parashikonte rinumërimin për shkak të fletëvotimeve të pavlefshme ose të zbrazëta sepse votuesit kishin të drejtë

⁴⁷ Disa prej parregullsive të pretenduara si ndikimi i paligjshëm në votues në ditën e zgjedhjeve as nuk mund të korrigjohej me rinumërim.

të votonin në këtë mënyrë të veçantë. Gjithashtu, parregullsi ndodhën edhe gjatë procesit zgjedhor dhe fletëvotimet e zbrazëta "nuk mund të shërbejnë si bazë për rinumërimin e votave"⁴⁸. Gjykata Supreme konstatoi se vendimi i PZAP-së nuk ishte bazuar në prova bindëse dhe se pretendimet e ankesës së LDK-së nuk ishin vërtetuar. Vlerësimi i PZAP-së i bazuar në rezultatet e ngushta ndërmjet dy kandidatëve, se shumë mospërputhje të fletëvotimeve të pavlefshme dhe të zbrazëta mund të ndikojnë në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve, nuk ishte e bazuar në ligj. Pretendimet e tjera të bëra nga LDK-ja nuk mund të shërbenin si bazë ligjore për të urdhëruar rinumërimin e votave.

Në rastin e Prizrenit, Gjykata Supreme konstatoi, siç ishte parashtruar nga VV, disa nga parregullsitë e përmendura në procesin zgjedhor tashmë ishin vërejtur dhe korrigjuar nga QNR. Gjykata Supreme gjeti se arsyetimet e PZAP-së për aprovimin e ankesës së PDK-së nuk ishin të mjaftueshme dhe nuk bazoheshin në prova të qarta dhe bindëse. Për më tepër, KQZ tashmë i kishte korrigjuar gabimet lidhur me numërimin e votave. Fakti që rezultatet ndërmjet dy kandidatëve ishin mjaft të ngushta dhe fakti që numri i fletëvotimeve të pavlefshme dhe të zbrazëta ishte aq i madh, nuk u pranua si arsye për rinumërim. Përkundrazi, provat e ofruara kanë të bëjnë vetëm me një numër të vogël votash në krahasim me numrin e përgjithshëm të votave të hedhura në komunën e Prizrenit. Arsyetimi i ofruar nga PZAP për ruajtjen e besimit dhe transparencës së procesit zgjedhor nuk mund të pranohej si i bazuar, pasi besimi dhe transparenca nuk u vunë në pikëpyetje pasi që gabimet eventuale ishin korrigjuar nga KQZ-ja.

Më 24 nëntor, në PZAP u parashtruan dy ankesa lidhur me votat e VJK-së në Istog dhe Kllokot, pas numërimit të votave përkatëse. PZAP i hetoi këto fletëvotime në QNR.

Lidhur me Kllokotin, kandidati (fillimisht) për kryetar komune i Listës Serbe, Strahinja Spasiq, u ankua në PZAP se gjatë numërimit të votave me kusht dhe votave me postë në QNR, vëzhguesit e tij vunë re se 19 fletëvotime me postë nga Serbia ishin identike, një ishte origjinal dhe 18 fotokopje. Të përfshira si dëshmi ishin deklaratat e pesë vëzhguesve të pranishëm gjatë procesit të numërimit dhe deklaratat e qytetarëve që votuan për Strahinja Spasiq përmes votimit me postë, megjithatë asnjë votë me postë nuk i ishte numëruar Spasiqit në raundin e dytë të zgjedhjeve. Meqenëse z. Spasiq ishte në epërsi me 10 vota në garën për kryetar komune në Kllokot, para se t'i shtoheshin 19 votat e VJK-së, kjo çështje e vendosi garën. PZAP refuzoi ankesën e kandidatit për kryetar të Kllokotit nga Lista Serbe si të pabazuar, pasi ata argumentuan se fletëvotimet e hetuara kishin ardhur në tri lloje të ndryshme të zarfeve. Fletëvotimet ishin të shënjuara me stilolaps dhe nuk treguan shenja të fotokopjimit të stilolapsit. PZAP në arsyetimin e vet nuk përmendi deklaratat e qytetarëve të cilët pretendonin se kishin votuar për Strahinja Spasiq përmes votimit me postë.

PZAP e pranoi si të bazuar ankesën e LDK-së dhe vendosi të anulojë rezultatet e raundit të dytë të zgjedhjeve për kryetar komune, të mbajtura më 19 nëntor në Istog, duke urdhëruar KQZ-në të përsërisë votimin e këtij raundi të dytë në Istog. LDK në fakt kërkoi vetëm anulimin e të gjitha votave me postë dhe përjashtimin e tyre nga rezultati përfundimtar. Pas një hetimi të plotë, PZAP-ja vendosi që ka të ngjarë që shumica e votave të VJK-së të jenë mashtruese, p.sh. duke kontrolluar mostra të konsiderueshme të numrave të telefonit të dhënë nga votuesit e dyshuar ose duke ekzaminuar certifikatat e vdekjes të njerëzve që supozohet se kanë votuar. Megjithatë, disa prej votave të VJK-së

⁴⁸ Dy vendimet e Gjykatës Supreme po ashtu ishin të arsyetuara dobët. Thënë në përgjithësi, përveç ankesave të parashtruara nga VV në Gjykatën Supreme, cilësia e dokumenteve ligjore në këtë poçe ishte e ulët, duke marr parasysh rëndësinë – ankesat nga LDK dhe PDK në PZAP nuk ishin argumentuar mirë dhe ishin ofruar pak dëshmi, as vendimet e PZAP-së e as ato të Gjykatës Supreme nuk ishin të strukturuar ose arsyetuara siç do të mund të pritej në këtë nivel dhe me këto gjëra që janë në pyetje.

dolën të jenë të ligjshme. Kjo e motivoi PZAP-në që të anulojë jo vetëm votën e VjK-së në Istog, por të gjithë raundin e dytë dhe të urdhërojë KQZ-në të përsërisë votimin përkatës. Edhe AAK edhe LDK u ankuan për këtë vendim në Gjykatën Supreme, AAK duke kërkuar refuzimin e ankesës së LDK-së, LDK duke kërkuar që vendimi i PZAP-së të ndryshohet vetëm për të anuluar votat e VjK-së. Gjykata Supreme e mbështeti vendimin e PZAP-së.

Ankesat kundër rezultateve përfundimtare të publikuara nga KQZ-ja

Me 29 nëntor, pas publikimit të rezultateve të raundit të dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave, në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP) u parashtruan shtatë ankesa lidhur me rezultateve përfundimtare të publikuara. Dy ankesa u paraqitën në Gjykatën Supreme lidhur me vendimin e PZAP-së për votat e VjK-së në Istog.

LDK parashtrroi tri ankesa lidhur me rezultatet, një për Dragash, një për Kamenicë dhe një për Prishtinë. Kjo e fundit, duke kërkuar përsëri një rinumërim të plotë për Prishtinën, i përsërit shumë nga pretendimet e ankesës së tyre të parashtruar brenda afatit 24 orësh pas ditës së zgjedhjeve, por është më e detajuar dhe me pretendime të shtuara për disa shkelje, si ndikimi i paligjshëm në votues, mospërputhjet dhe ndërhyrjet në formularët e rezultateve, mungesa e fletëvotimeve në zarfet e votimit me kusht ose një numër i madh i fletëvotimeve të pavlefshme. PZAP-ja i hodhi poshtë shumë nga këto argumente si të pa lejuara, sepse ishin paraqitur shumë vonë, pasi ato duhej të ishin sjellë brenda 24 orëve nga mbyllja e vendvotimeve ose pasi janë vërejtur në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), dhe gjithashtu vuri në dukje se një numër i këtyre akuzave tashmë ishte gjykuar. Sa i përket pretendimeve se disa fletëvotime në mënyrë të paligjshme ishin shpallur si të pavlefshme, PZAP-ja zhvilloi hetime në QNR dhe konstatoi se ato janë të pabazuara.

Në rastin e Kamenicës, LDK-ja pretendoi se kryetari i zgjedhur nuk kishte jetuar në Kamenicë për një periudhë prej tre vjetësh, një kërkesë ligjore për kandidatët për kryetar komune. PZAP-ja e hodhi poshtë ankesën si të parashtruar pas afatit, duke arsyetuar se KQZ-ja kishte certifikuar kandidatët e VV-së më 30 gusht 2017. Afati i fundit për paraqitjen e ankesës kundër këtij vendimi të KQZ-së ishte më 4 shtator 2017, por në atë kohë nuk është paraqitur asnjë ankesë.

Partia Demokratike e Kosovës gjithashtu paraqiti tri ankesa, një për Rahovec, një për Klinë dhe një për Prizren. Sa i përket Prizrenit, PDK-ja kërkoi që të anulohen rezultatet e 26 vendvotimeve dhe nëse këto parregullsi kanë mund të ndikonin në rezultatet përfundimtare, të urdhërojë KQZ-në të zhvillojë një rivotim të plotë në komunën e Prizrenit. Kjo ankesë po ashtu i përsëriti shumë prej pretendimeve të ankesës përkatëse të parashtruar pas ditës së zgjedhjeve. PZAP-ja refuzoi ankesën si të palejueshme sepse është paraqitur tepër vonë, pasi ajo është dashur të ishte sjellë brenda 24 orëve nga mbyllja e vendvotimeve dhe kryesisht tashmë të ishte gjykuar.

Fatmir Rashiti, i cili garoi si kandidat i pavarur në komunën e Shtimes, paraqiti një ankesë duke pretenduar parregullsi dhe duke kërkuar rivotim. PZAP e refuzoi ankesën si të pa lejuar sepse është paraqitur shumë vonë, pasi ajo është dashur të parashtrohej brenda 24 orëve nga mbyllja e vendvotimeve.

Ankesat në Gjykatën Supreme

Janë parashtruar katër ankesa kundër këtyre vendimeve të PZAP-së në Gjykatën Supreme, e cila mbështeti plotësisht vendimet e PZAP-së lidhur me Prizrenin dhe Klinën me 7 dhjetor, dhe ato në lidhje me Rahovecin dhe Prishtinën me 8 dhjetor. Gjykata Supreme konstatoi në disa detaje se vendimet e PZAP-it ishin të bazuara mirë si në aspektin faktik ashtu edhe në atë ligjor. Gjykata

vlërësoi se pretendimet në ankesat e parashtruara kundër vendimeve të kontestuara të PZAP-së ishin të pabazuara, sepse ato ishin në kundërshtim me faktet e vërtetuara mirë nga PZAP dhe me provat në shkresat e lëndës. Ankuesit kishin dështuar të paraqesin dëshmi relevante lidhur me pretendimet e tyre. Gjykata gjithashtu konsideroi se PZAP kishte vendosur me të drejtë se lidhur me parregullsitë gjatë procesit zgjedhor në ditën e zgjedhjeve për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetar komune të mbajtur më 19 nëntor 2017, afati ligjor për të paraqitur një ankesë ishte 24 orë pas mbylljes e vendotimeve.

Ankesat kundër vendimeve të PZAP-së lidhur me Votimet jashtë Kosove

Pas një afati të ndryshëm kohor, pasi që ky proces i ankesave dhe parashtrësive nuk u nxit nga publikimi i rezultateve përfundimtare, por nga vëzhgimi i parregullsive në votat e VJK-së të numëruara në QNR, më 29 nëntor u parashtruan dy ankesa në Gjykatën Supreme kundër vendimit të PZAP-së që urdhëroi një rivotim të plotë për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetar të komunës në Istog. Një nga ankesat është parashtruar nga LDK, duke kërkuar që vetëm votat e VJK-së të anulohen dhe të përjashtohen nga rezultatet. Ankesa tjetër, e parashtruar nga AAK, kërkonte të anulohet vendimi i PZAP-së dhe të refuzohej ankesa e LDK-së në PZAP, duke konfirmuar rezultatet përfundimtare të publikuara nga KQZ. Një tjetër ankesë ishte parashtruar nga Lista Serbe kundër vendimit të PZAP-së duke hedhur poshtë një ankesë lidhur me votat e VJK-së në Kllokot. Më 1 dhjetor, Gjykata Supreme i mbështeti plotësisht të dy këto ankesa kundër vendimeve të PZAP-së, duke konfirmuar kështu një rivotim të plotë për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetar komune në Istog, me masat e shtuara që duhej të merren nga KQZ-ja për të shmangur mashtrimin me votat VJK, si dhe konfirmimin e rezultateve për Kllokotin.

Pas publikimit të rezultateve përfundimtare për zgjedhjet për kryetar të komunës në Kllokot me 7 dhjetor, me 8 dhjetor kandidati për kryetar të komunës nga Lista Serbe paraqiti një ankesë tjetër në PZAP.

PZAP-ja rrjedhimisht ka zgjidhur ankesat brenda afatit ligjor, por në mungesë të dëshmive të nevojshme dhe bindëse, ose para publikimit të rezultateve përfundimtare, hodhi poshtë shumë prej tyre. Për dallim nga gjobat e konsiderueshme (257,350 euro) që iu shqiptuan subjekteve politike për shkelje të rregullave të fushatës, asnjë gjobë nuk ju shqiptua individëve për ankesat lidhur me ditën e zgjedhjeve (votimin dhe numërimin)⁴⁹.

Njohja e procesit të ankesave të PZAP dhe besimi në institucion ndryshojnë shumë. Derisa subjektet politike në shumicën e rajoneve duken të sigurt në njohuritë e tyre për procedurën e kërkuar dhe zakonisht parashtrojnë ankesa përmes selisë së tyre në Prishtinë, ekziston një konsensus i përgjithshëm se votuesit individualë nuk dinë të parashtrojnë ankesa në PZAP. Besimi në PZAP si institucion i pavarur në përgjithësi nuk është më i lartë se në sistemin gjyqësor dhe është dëmtuar nga vendimet jo të arsyeshme për të rinumëruar plotësisht të gjitha vendvotimet në Prishtinë dhe Prizren pas raundit të dytë të zgjedhjeve komunale, të cilat nuk u mbështeten nga Gjykata Supreme.

Mbrojtja e votës

⁴⁹ Kjo shumë e përgjithshme ka rënë dukshëm nga 357,200 euro sa u ishin shqiptuar subjekteve politike në zgjedhjet parlamentare në qershor 2017. Duket se shumë kandidatë dhe parti kanë vendosur të përdorin më pak posterë gjatë fushatës tani, posterët në vendet e papërshtatshme ishin arsyeja më e shpeshtë për gjoba.

Shkeljet që mund të ndikojnë në rezultatet e zgjedhjeve, përveç se janë shkelje administrative, mund të trajtohen edhe si vepra penale. Në raste të tilla, PZAP e dërgon çështjen në zyrën e Kryeprokurorit dhe në polici, për të ndjekur çështjen penale. Kjo nuk e zhvesh PZAP-në nga juridiksioni për të përcaktuar përgjegjësinë administrative. Bashkëpunimi i PZAP-it me policinë dhe prokurorinë teorikisht është përmirësuar përmes institucionalizimit të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet këtyre institucioneve dhe KQZ-së. Në praktikë, veprimet e ndërmarra nga prokurorët pas dërgimit të lëndëve të PZAP-së ndryshon (ndryshojnë) shumë.

Plani operativ i policisë dhe Koordinatori Kombëtar për Zgjedhjet në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit që përfshinte shpërndarjen e më shumë se 100 prokurorëve në ditën e parë të zgjedhjeve rezultuan në 13 raste dhe një numër të paraburgimeve të përkohshme. Shumica e rasteve kishin të bënin me incidentet të vogla, dhe ende ishin duke u hetuar nga policia në fillim të dhjetorit dhe ka gjasa që të mos çojnë në aktakuzë. Nuk ndodhi asnjë incident i madh në ditën e dytë të zgjedhjeve. Policia dhe prokuroria raportuan 23 intervenime të vogla. Vetëm një nga këto incidente çoi në hapjen e procedurës penale lidhur me krimin zgjedhor, pengim i procesit të votimit, për qëndrimin e pretenduar në korridorin e shkollës për 20 minuta dhe pengimin e procesit zgjedhor. Me 8 dhjetor, PZAP ia dërgoi prokurorisë një lëndë lidhur me manipulimin e votimit jashtë Kosovës në Istog. Koordinatori i Zgjedhjeve në Zyrën e Kryeprokurorit konfirmoi se të gjitha rastet e zgjedhjeve të trajtuara nga prokuroritë rajonale ende ishin nën hetim në kohën e shkrimit të këtij raporti. Këto përfshinë, mes tjerash, një rast ku pretendohet pengimi i procesit të votimit, që prokuroria e konsideron me mundësi që të rezultojë me aktakuzë, dhe rastet lidhur me blerjen e pretenduar të votave në Partesh dhe Gjakovë, ku disa prej të akuzuarve u paraburgosën deri në 30 ditë para se të lirohen me procedurë të rregullt.

Baza e të dhënave të QNR-së nuk lejon që të përcillen ndryshimet në proces, ose të merret një rast, të bëhet një koment dhe të përcillet ai në KQZ për trajtim të mëtejshëm (si dërgimi në prokurori). KQZ-ja pretendon se do të dërgojë në prokurori të gjitha votat e dyfishta dhe të gjitha rastet e rinumërimit kur ka më shumë mundësi të ketë pasur mashtrim e jo thjeshtë gabim. PZAP po ashtu e ka deklaruar synimin e tyre për të dërguar rastet e pretenduara të krimeve zgjedhore në prokurori dhe e ka bërë këtë në disa raste. Koordinatori Kombëtar për Zgjedhje në Zyrën e Kryeprokurorit ka deklaruar se prokuroria do të përpiqet që të veprojë shpejt në këto raste sapo të pranohen ato, në mënyrë që të dërgojë me kohë sinjale të duhura parandaluese për zgjedhjet komunale, ku është e mundur.⁵⁰

Për shkak të mungesës së një sistemi të integruar (ose çfarëdo) të menaxhimit të rasteve në mes të prokurorisë së Kosovës dhe sistemit gjyqësor, mbledhja e të dhënave për rastet e ndjekura penalisht është e vështirë. Këto të dhëna prodhohen në mënyrë manuale varësisht nga nevojat e institucionit përkatës.⁵¹

Përveç faktit se informacioni i dhënë në 23 rastet e mësipërme ishte shumë i pakët, shtrohet pyetja se çfarë ndodhi me të gjitha akuzat e tjera për shkelje zgjedhore. Edhe pse EU EOM-së iu tha se ato mund të jenë ende nën hetime, nuk ka informacione zyrtare për të konfirmuar këtë. Kjo mungesë e

⁵⁰ Megjithatë, KQZ akoma nuk i ka dërguar në prokurori asnjë nga qindra rastet e dyshimta nga rinumërimet gjatë zgjedhjeve parlamentare të qershorit 2017.

⁵¹ Të dhënat për ndjekjen penale pas zgjedhjeve të 2014 janë mbledhur nga shtatë prokuroritë kryesore në Kosovë. Të dhënat e ofruara tregojnë se prej më shumë se 600 pretendimeve për krime zgjedhore prokuroritë në Kosovë kanë trajtuar 23 aktakuza që përfshinin 26 të dyshuar për vepra penale lidhur me zgjedhjet 2014. Të gjitha këto raste çuan në dënime me kusht, përveç një rasti në Mitrovicën Jugore, i cili është ende nën hetim. Meqë periudhat e parashkrimit në Kosovë janë mjaft të shkurtra, shumica e këtyre pretendimeve ka mundësi të mos gjykojnë kurrë.

provave se të gjitha ose shumica e krimeve elektorale janë ndëshkuar ka mundësi të zvogëlojë efektin parandalues të legjislacionit për krime zgjedhore.

Shoqëria civile dhe vëzhguesit vendorë

KQZ ka akredituar një numër të përgjithshëm prej 33,862 vëzhguesve në mënyrë gjithëpërfshirëse, duke rritur transparencën e procesit zgjedhor. Më shumë se 29,000 vëzhgues të akredituar ishin nga subjektet e certifikuara politike dhe rreth 3,700 nga OJQ-të vendore.

Grupi kryesor i vëzhguesve vendorë të Kosovës, Demokracia në Veprim (DnV), luajti një rol të rëndësishëm duke shpërndarë rreth 3,000 vëzhgues për raundin e parë të zgjedhjeve lokale dhe 1,784 vëzhgues për raundin e dytë. DnV publikoi një numër raportesh dhe deklaratash lidhur me analizën e tyre të fushatës zgjedhore dhe të dy raundeve të zgjedhjeve. Qendra e tyre e thirrjeve i mori rezultatet e zgjedhjeve për kryetarë të komunave nga vëzhguesit në vendvotime dhe e publikoi një tabelim paralel të votave në të dy raundet e zgjedhjeve lokale.

REKOMANDIMET

Korniza Ligjore

Nr.	Faqe	Synimi	Rekomandimi	Aktivitetet e sugjeruara	Institucionet e synuara	Parimi
1	f.	Zbatimi efektiv i të drejtës për të kandiduar për një pozitë në zgjedhje.	Të ofrohet siguri ligjore dhe kushtetuese për kërkesat e përshtatshmërisë (kualifikimit) së kandidatit pas vendimit të Gjykatës Supreme për de-certifikimin e kandidatëve.	Ndryshimet në LZP.	Kuvendi i Kosovës në bashkëpunim të ngushtë me KQZ-në, PZAP-në	Siguria ligjore, CGPEM (VC) Kapitulli 2: KEDNJ, neni 13; ICCPR, Neni 2.
2	f.	Të ofrohet siguri ligjore për afate të ndryshme të ankesës, dhe mundësi për të paraqitur parashtrës ose ankesa kundër rezultateve përfundimtare. T'i jepet kohë e mjaftueshme ankuesit për të përgatitur ankesën lidhur me votimin dhe numërimin dhe për të paraqitur prova dhe PZAP-së për të shqyrtuar provat para marrjes së vendimit.	LZP duhet të ndryshohet që të ofroj qartësi lidhur me afatet dhe përmbajtjen e nevojshme të parashtrësave dhe ankesave. Afatet për paraqitjen e ankesave për zgjedhje duhet të zgjaten në 48 orë dhe afati kohor për PZAP-në për të vendosur mbi ankesat kundër rezultateve të zgjatet deri në 5 ditë.	Ndryshimi dhe konsolidimi i LZP-së së ndryshuar. Një ndryshim që prek pjesë të konsiderueshme të tekstit po ashtu do të çoj në publikimin aq të nevojshëm të një versioni të konsoliduar të LZP-së dhe Ligjit(eve) të ndryshuar	Kuvendi i Kosovës në bashkëpunim të ngushtë me KQZ-në, PZAP-në	Siguria ligjore, e drejta për mjete efektiv, CGPEM (VC) Kapitulli 2; KEDNJ, neni 13; ICCPR, Neni 2; UDHR, neni 8.

Nr.	Faqe	Synimi	Rekomandimi	Aktivitetet e sugjeruara	Institucionet e synuara	Parimi
3	p.	T'i sigurohen PZAP-së resurset për të zgjidhur një numër të madh të rasteve, përfshirë shqyrtimin e provave para marrjes së çdo vendimi.	T'i ofrohen PZAP-së resurset adekuate, duke përfshirë hapësirën për të punuar në një numër të madh të rasteve në një kohë shumë të shkurtër.	Të rriten resurset e PZAP-së, të ofrohen hapësirat adekuate.	Ministria e Financave, Ministria e Administratës Publike, në bashkëpunim të ngushtë me KQZ-në dhe PZAP-në.	E drejta për mjete efektive; KEDNJ, neni 13; KNDCP, Neni 2; UDHR, neni 8.
4	p.	Të rritet besueshmëria e procesit zgjedhor, dekurajimi i krimeve zgjedhore.	Të gjitha krimet zgjedhore, përfshirë edhe ato të kryera gjatë zgjedhjeve të mëparshme, duhet të hetohen në mënyrë energjike, të ndiqen penalisht dhe aty ku përcaktohet përgjegjësia personale të ndëshkohen në të gjitha nivelet. Duhet të krijohet një bazë të dhënash me një numër të vetëm, ku rastet lidhur me zgjedhjet të mund të gjurmohen nga policia në prokurori deri te vendimi i gjykatës. Nëse kjo bazë e planifikuar e të dhënave nuk bëhet funksionale deri në janar 2018, duhet të zbatohet një sistem i veçantë.	Zhvillimi i hetimeve të plota, ndjekja penale dhe gjykimi në lidhje me akuzat për krime zgjedhore. Të sigurohet publikimi i rregullt dhe i gjerë i rezultateve të këtyre përpjekjeve. Themelimi i një baze të dhënash me një numër të vetëm ku rastet mund të gjurmohen nga policia në prokurori deri në vendimin e gjykatës.	Policia Prokurorët Gjykatat Këshilli Gjyqësor i Kosovës, PZAP, KQZ	E drejta e votës së lirë; Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore i Komisionit të Venedikut të Këshillit të Evropës E drejta për zgjidhje efektive; KEDNJ, neni 13; ICCPR, Neni 2; UDHR, neni 8. Shprehja e lirë e votuesve, Zgjedhjet e mirëfillta; ICCPR Neni 25

Fushata

Nr.	Faqe	Synimi	Rekomandimi	Aktivitetet e sugjeruara	Institucionet e synuara	Parimi
5		Të sigurohet konsistencë në zbatimin e rregulloreve të fushatës	Rregullat e fushatës lidhur me përfshirjen e nëpunësve civilë në fushatat zgjedhore duhet të zhvillohen më tej	Ndryshimet në LZP, LZL dhe Rregulloren Zgjedhore të KQZ-së nr. 11/2013	Kuvendi i Kosovës KQZ	Zbatimi i rregullave të fushatës
6		Të përmirësohet pjesëmarrja e grave në procesin zgjedhor	Partitë politike të identifikojnë masa efektive për rritjen e pjesëmarrjes së grave në pozita udhëheqëse në aktivitete të partisë/ aktivitete zgjedhore	Ndryshimet e rregulloreve të brendshme të partive politike	Subjektet politike Shoqëria civile	CEDAW, Neni 3 & Neni 7; Udhëzime për rregullimin e partive politike nga OSBE/ODIHR dhe Komisioni i Venedikut, Kapitulli IX.
7		Të sigurohet e drejta e qytetarëve për të shprehur preferencat e tyre politike, si votues dhe si kandidatë	Institucionet duhet të sigurojnë hetimin e duhur dhe të menjëhershëm, ndjekjen dhe gjykimin e rasteve të frikësimit/ndikimit të paligjshëm në votues dhe kandidatë	Të zhvillohen hetime të shpejta dhe të plota të akuzave për frikësim/ trysni dhe blerje të votave në tërë Kosovën	Policia Prokurorët Gjykatat Këshilli Gjyqësor i Kosovës,	E drejta e votës së lirë; Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, e Komisioni i Venedikut
8		Të sigurohet konsistenca në zbatimin e rregulloreve të fushatës	Të sqarohen dispozitat e LZP-së lidhur me përfshirjen e të miturve në fushatën elektorale	Ndryshime në Rregulloren Zgjedhore të KQZ-së nr. 13/2013	KQZ	Zbatimi i rregullave të fushatës

Financimi i fushatës

Nr.	Faqe	Synimi	Rekomandimi	Aktivitetet e sugjeruara	Institucionet e synuara	Parimi
9		Të angazhohen të gjithë akterëve relevantë në një rishikim gjithëpërfshirës të kornizës ligjor për financimin e fushatës, brenda formatit të Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës	Të bëhet një rishikim gjithëpërfshirës i kornizës ligjore që rregullon fushatën dhe financimin e partive politike	Ndryshimet në Ligjin nr. 03/L-174 për financimin e partive politike	Kuvendi i Kosovës KQZ	Zbatimi i rregullave të fushatës
10		Zbatimi efektiv i kushteve për financimin e fushatës	Auditimi i financave të fushatës së garuesve në zgjedhje duhet të bëhet në mënyrë efektive	Kuvendi i Kosovës duhet të identifikojë një institucion të pavarur i ngarkuar që të bëjë auditimin e raporteve financiare. Rritja e burimeve të KQZ/OPPR për të trajnuar siç duhet zyrtarët financiarë të partive politike	Kuvendi i Kosovës KQZ	Zbatimi i rregullave të fushatës; Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës, Kapitulli II.3.5 mbi Financimin në Raportin Shpjegues
11		Të rritet transparenca e financimit të fushatës	Subjektet politike duhet të mbajnë një llogari të veçantë bankare për financimin e fushatës, ku mblidhen të gjitha burimet e të ardhurave dhe shpenzimet gjatë fushatës, si në nivel qendror ashtu edhe atë rajonal.	Ndryshimet në Ligjin nr. 03/L-174 për financimin e partive politike Konsultimet publike me palët e interesuara për të identifikuar institucionin e duhur për të kryer një auditim të pavarur të raporteve financiare	Kuvendi i Kosovës KQZ	Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore e Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës Kapitulli II.3.5 mbi Financimin në Raportin Shpjegues

Nr.	Faqe	Synimi	Rekomandimi	Aktivitetet e sugjeruara	Institucionet e synuara	Parimi
12		Të rritet transparencja e financimit të fushatës	Kapaciteti i organizatave të shoqërisë civile për të monitoruar financimin e fushatës dhe mediat duhet të forcohet	Resurset dhe metodologjia duhet të vihen në dispozicion të organizatave të shoqërisë civile	Organizatave të shoqërisë civile	Garantimi i ushtrimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut

Administrimi i zgjedhjeve

Nr.	Faqe	Synimi	Rekomandimi	Aktivitetet e sugjeruara	Institucionet e synuara	Parimi
13		Të përmirësohet kapaciteti i votuesve që vota e tyre të jetë e vlefshme	Përmirësimi i dizajnit të fletëvotimeve për zgjedhjet për kuvendet komunale që votuesit t'i kuptojnë më mirë. Të përmirësohet informimi i votuesve për mënyrën se si duhet të shënjojnë një fletëvotim.	Analizimi i fletëvotimeve të pavlefshme nga zgjedhjet lokale të vitit 2017 dhe aplikimi i dizajnit të ri të fletëvotimeve për zgjedhjet për kuvendet komunale. Informimi i votuesve duhet të përdorë kanale të ndryshme për të qenë më efektiv.	KQZ	E drejta për të votuar, ICCPR neni 25 Transparenca dhe e drejta në informim ICCPR, Komenti i Përgjithshëm 25, paragrafi 11, 12; Komenti i Përgjithshëm 34
14		Të përmirësohet efikasiteti dhe performanca e administratës së zgjedhjeve, veçanërisht e Këshillave të Vendvotimeve (KVV)	Të krijohet pozita e Sekretarit të KVV-së për të siguruar mbështetjen e nevojshme këshilluese dhe administrative për Kryesuesin e KVV-së. Sekretari mund të rekrutohet dhe trajnohet nga KQZ/KKZ nga radhët e anëtarëve të administratës publike. Të	KQZ-ja dhe KKZ-të do të vlerësojnë sistematikisht performancën e anëtarëve të KVV-ve dhe do të vendosin dhe mirëmbajnë	KQZ	Zgjedhjet e mirëfillta ICCPR Komenti i Përgjithshëm nr. 25, paragrafi 20

Nr.	Faqe	Synimi	Rekomandimi	Aktivitetet e sugjeruara	Institucionet e synuara	Parimi
			intensifikohen trajnimet e stafit e vendvotimeve për të adresuar mangësitë e përsëritura siç janë moszbatimi i procedurave të numërimit të votave dhe plotësimi jo i saktë i formularëve të rezultateve.	bazën e të dhënave të stafit të vendvotimeve. Përmirësimi i materialeve të trajnimit dhe kurrikulës për stafin e vendvotimeve dhe Kryesuesin e KVV-ve.		
15		Të adresohen mangësitë e procedurave të Votimit jashtë Kosovës (VjK)	Aplikimi i masave shpesh për verifikimin e votuesve të VjK-së për të mbrojtur integritetin e Votimit jashtë Kosovës kundër mashtrimit dhe paraqitjes së rreme si person tjetër. Shqyrtimi i afateve kohore për paraqitjen e listës së votuesve dhe periudhën e kundërshtimit që të mundësohen mjete juridike efektive për rastet e refuzimit të mundësisë për të votuar.	Ndryshimet në rregulloren e KQZ-së 03/2013 dhe 10/2013	KQZ	Zgjedhjet e mirëfillta ICCPR Komenti i Përgjithshëm nr. 25, paragrafi 20
16		Të përmirësohet saktësia e listave të votuesve dhe caktimi i votuesve në vendvotime	Dedikimi i përpjekjeve substanciale për të hequr personat e vdekur nga regjistrat civilë, dhe për të krijuar një sistem të unifikuar të adresave në Kosovë.	Ndryshime se si raportohen dhe regjistrohen rastet e vdekjes. Agjencia e Regjistrimit Civil dhe institucionet përkatëse të zbatojnë një sistem të unifikuar të adresave, dhe KQZ të caktojë si duhet votuesit nëpër vendvotime	Agjencia e Regjistrimit Civil, Ministria e Brendshme, Agjencia Kadastrale e Kosovës, Komunitat, KQZ	E drejta universale dhe e barabartë e votës, Kodi i Praktikave të Mira në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venedikut të Këshillit të Evropës 1.2.ii

Nr.	Faqe	Synimi	Rekomandimi	Aktivitetet e sugjeruara	Institucionet e synuara	Parimi
17		Të përmirësohet pjesëmarrja e grave në administratën e zgjedhjeve	Zbatimi i deklaratës së partive politike të vitit 2015 për të siguruar të paktën për qind të pjesëmarrjes së të dy gjinive në procesin zgjedhor.	Ndryshimi i Rregullores së KQZ-së 18/2016 dhe 19/2016	KQZ, subjektet politike	Barazia gjinore CEDAW, neni 3
18		Të përmirësohet transparenca, konsekuenca, saktësia dhe besimi i publikut në procesin e Tabelimit të Rezultateve	Përmirësimi i procesit të tabelimit në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve duke siguruar më shumë resurse, kontroll të cilësisë dhe teknologji të reja.	Të ri-dizajnohen operacionet e KQZ-së për të përdorur teknologjitë moderne për përmirësimin e saktësisë dhe informimit dhe qasjen e vëzhguesit në të gjitha fazat e tabelimit, numërimit dhe rinumërimit	KQZ, QNR	Zgjedhje të mirëfillta, Transparenca dhe e drejta në informim
19		Të përmirësohet integriteti dhe garantimi i fshehtësisë së votës. Të përmirësohen njohuritë e stafit të vendvotimeve rreth procesit të ankesave dhe përgjegjësisë penale	Të përfshihet trajnimi i kryesuesve të KVV-ve me një fokus të veçantë në parandalimin e votimit familjar/grupor dhe abuzimin me ndihmën në votim. Të përfshihet moduli ligjor mbi procedurat e ankesave dhe përgjegjësinë penale në seancat trajnuese të KVV-së të realizuara nga trajnuesit në vend se tu referohen prokurorëve.	Përmirësimi i moduleve të trajnimit dhe përmirësimi i Manualeve të Votimit për anëtarët e KVV-së	KQZ, PZAP	Të drejtat për mjete efektive, KEDNJ, neni 13; ICCPR, Neni 2; E drejta në votim të fshehtë
20		Të përmirësohet të kuptuarit e votuesve për procesin zgjedhor	Zbatimi i edukimit gjithëpërfshirës dhe në kohë i votuesve dhe informimi i votuesve për të drejtën për të votuar në zgjedhjet lokale (si të plotësohet një fletëvotim, si të gjeten vendvotimet dhe si të gjej komunën ku një votues ka të drejtë të votojë, si të aplikoj për votim përmes VjK ose për ndihmë në votim,	Të bëhen fushata për informimin e votuesve dhe fushata për edukimin e votuesve duke përdorur kanale të ndryshme (media online, media sociale, bashkëpunim me OJQ-të)	KQZ	E drejta për votim ICCPR Neni 25 E drejta për Informim ICCPR, Komenti i Përgjithshëm Nr.25, paragrafi

Nr.	Faqe	Synimi	Rekomandimi	Aktivitetet e sugjeruara	Institucionet e synuara	Parimi
			cilat dokumente pranohen për identifikimin e votuesve, krimet zgjedhore, procedurat e ankesave).	dhe targetimi i grupeve të ndryshme të votuesve.		11, 25;

Media

Nr.	Faqe	Qëllimi	Rekomandimi	Aktivitetet e sugjeruara	Institucionet e synuara	Parimi
21		Të kufizohet numri i programeve të sponsorizuara nga partitë politike të transmetuara nga mediat elektronike dhe të sigurohen kushte të barabarta për garuesit për të blerë kohën e transmetimit me pagesë.	Duhet marrë në konsideratë rregullimin e programeve të sponsorizuara nga partitë politike ngjashëm me spotet reklamuese politike me pagesë. (Rekomandim prioritar)	Ndryshimi i Rregullores KPM-2016/02 të Komisionit të Pavarur për Media (KPM) Ndryshimi Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme	Komisioni i Pavarur për Media Kuvendi i Kosovës	Neni 2.3, Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore i Komisionit të Venedikut të Këshillit të Evropës.
22		Të sigurohet një trup rregullator operacional dhe efektiv për media elektronike (Komisioni i Pavarur i Mediave).	Duhet marrë në konsideratë emërimin me kohë të të shtatë anëtarëve të KPM-së dhe tre anëtarëve të Bordit të ANkesave për të garantuar kuorumin e nevojshëm për marrjen e vendimeve.	Sigurimi i vazhdimet me kohë të mandateve të anëtarëve të KPM-së dhe angazhimi i tyre i plotë për të garantuar lehtësisht kuorumin e nevojshëm për të mbajtur takimet dhe për të marr vendime. Zbatimi i Nenit 11 dhe Nenit 38, Ligji për Komisionin e Pavarur për Media.	Kuvendi i Kosovës	Siguria ligjore

Nr.	Faqe	Qëllimi	Rekomandimi	Aktivitetet e sugjeruara	Institucionet e synuara	Parimi
23		Të sigurohen sanksione efektive për shkeljet dhe korrigjimet pas ankesave gjatë periudhës së zgjedhjeve	Duhet marrë parasysh që KPM-ja të mbajë takime të rregullta dhe të shpeshta gjatë periudhës së zgjedhjeve.	Të mbahen mbledhje të rregullta dhe të shpeshta të anëtarëve të KPM-së gjatë periudhës së zgjedhjeve për të adresuar ankesat e pranuar dhe shkeljet e zbuluara nga departamenti i monitorimit të medias. Zbatimi i Nenit 15.3 i Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media.	Komisioni i Pavarur për Media	E drejta për mjet juridik efektiv
24		Të përmirësohet informimi publik për aktivitetet dhe gjetjet e Komisionit të Pavarur për Media. Të rritet ndërgjegjësimi publik dhe medial mbi rregullat e medias.	Duhet marrë në konsideratë që të ndahen me publikun në mënyrë aktive informacionet mbi aktivitetet dhe gjetjet e KPM-së.	Të lëshohet deklarata publike nëpërmjet medias elektronike dhe të organizohen konferenca shtypi për të paraqitur raporte mbi gjetjet e saj, veçanërisht rezultatet dhe vendimet e monitorimit të mediave lidhur me zgjedhjet. Zbatimi i nenit 5.2 i Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media.	Komisioni i Pavarur për Media	Transparenca E drejta për informim

REZULTATET E MONITORIMIT TË MEDIAVE NGA EU EOM

Zgjedhjet Komunale dhe për Kryetarë të Komunave, Kosovë 2017

HYRJE

EU EOM ka bërë një monitorim sasior dhe cilësor të mediave me një mostër të mediave elektronike gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet e 22 tetorit (21 shtator - 20 tetor 2017) dhe gjatë fushatës zgjedhore për raundin e dytë (13 - 17 nëntor 2017).

Monitorimi i mediave elektronike u bë çdo ditë prej orës 17:00 deri në 01:00, mostrën e përzgjedhur e përbënin këto kanale televizive:

- ✓ **RTK1**, kanal televiziv publik (në gjuhën shqipe)
- ✓ **RTK2**, kanal televiziv publik (në gjuhën serbe dhe të komuniteteve jo-shumicë)
- ✓ **KTV**, kanal televiziv privat (në gjuhën shqipe)
- ✓ **RTV21**, kanal televiziv privat (në gjuhën shqipe)
- ✓ **KLAN KOSOVA**, kanal televiziv privat (në gjuhën shqipe)
- ✓ **TV DUKAGJINI**, kanal televiziv privat (në gjuhën shqipe)

Përveç këtyre, monitorimi i mediave përfshiu edhe programet e lajmeve kryesore të ditës të dy kanaleve televizive lokale që transmetojnë në gjuhën serbe, **TV MOST** dhe **TV PULS**.


EU EOM bëri edhe monitorimin cilësor të tetë kanaleve televizive të lartpërmendura gjatë fushatës parazgjedhore (16 - 20 shtator 2017), ndërmjet dy fushatave zgjedhore (23 tetor - 12 nëntor 2017), në periudhën pas zgjedhore (20 -30 nëntor 2017), si dhe gjatë periudhave të heshtjes zgjedhore (21-22 tetor dhe 18-19 nëntor 2017). Po ashtu u bë edhe monitorimi cilësor i një mostre të mediave të lajmeve online dhe mediave sociale (faqeve të Facebook-ut).

Në faqet në vazhdim, ju mund të gjeni një përmbledhje të rezultateve për monitorimin cilësor të mediave elektronike.⁵²


⁵² Toni i përdorur për subjektet institucionale dhe politike nga mediat elektronike kryesore të monitoruara ishte kryesisht neutral; prandaj, grafikët lidhur me tonin e mediave nuk janë përfshirë në këtë përmbledhje. Për më tepër, duke e pasqyruar fushatën zgjedhore të profilit të ulët në komunat me shumicë serbe, TV MOST, TV PULS si dhe kanali i dytë i televizionit publik RTK2 në gjuhën serbe dhe të komuniteteve jo-shumicë ofruan një mbulueshmëri minimale të garuesve në zgjedhje, prandaj rezultatet e tyre sasiorë të monitorimit të mediave nuk janë përfshirë në këtë raport.

**MBULUESHMËRIA POLITIKE DHE ZGJEDHORE
FUSHATA ZGJEDHORE PËR DITËN E ZGJEDHJEVE TË 22 TETORIT 2017 (Raundi i parë)**

**MBULUESHMËRIA E PËRGJITHSHME POLITIKE DHE ZGJEDHORE
21 shtator – 20 tetor 2017 (në sekonda)**




**MBULUESHMËRIA POLITIKE DHE ZGJEDHORE
Dhjetë ditët e fundit të fushatës zgjedhore 11 – 20 tetor 2017 (në sekonda)**




RTK1 – KANALI TELEVIZIV PUBLIK (në gjuhën shqipe)

**MBULUESHMËRIA NË LAJME – RTK1
21 shtator – 20 tetor 2017**




KTV (KANAL TELEVIZIV PRIVAT)

**MBULUESHMËRIA NË LAJME – KTV
21 shtator – 20 tetor 2017**




RTV21 (KANAL TELEVIZIV PRIVAT)

MBULUESHMËRIA NË LAJME – RTV 21
21 shtator – 20 tetor 2017




KLAN KOSOVA TV (KANAL TELEVIZIV PRIVAT)

MBULUESHMËRIA NË LAJME – KLAN KOSOVA
21 shtator – 20 tetor 2017




TV DUKAGJINI (KANAL TELEVIZIV PRIVAT)

**MBULUESHMËRIA NË LAJME – TV DUKAGJINI
21 shtator – 20 tetor 2017**




PROGRAMET POLITIKE TË SPONZORUARA

**PROGRAMET E SPONZORUARA POLITIKE
21 shtator – 20 tetor 2017 (në sekonda)**




REKLAMAT POLITIKE ME PAGESË

REKLAMAT POLITIKE ME PAGESË - SPOTET 21 shtator – 20 tetor 2017 (në sekonda)




FUSHATA ZGJEDHORE PËR RAUNDIN E DYTË


MBULUESHMËRIA POLITIKE DHE ZGJEDHORE Fushata zgjedhore e raundit të dytë 13 – 17 nëntor 2017 (në sekonda)



MBULUESHMËRIA ME RAPORTIM
Fushata zgjedhore e raundit të dytë 13 – 17 nëntor 2017
(në sekonda)



PROGRAMET E SPONZORUARA POLITIKE
Fushata zgjedhore e raundit të dytë 13 – 17 nëntor 2017
(në sekonda)



REKLAMAT POLITIKE ME PAGESË – SPOTET
Fushata zgjedhore e raundit të dytë 13 – 17 nëntor 2017
(në sekonda)

